

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7334 E ejte 26 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

I gjithë qëllimi i politikës praktike është ta mbajë popullatën të alarmuar (dhe kështu edhe në tollori për të mbetur vetë në siguri) me një seri të ...
Vijon në faqen 20

Nga BEN ANDONI

Strategjia e tensionit, arma e bukur e Ramës dhe Bashës



Deklarata

Ditës

Shoqata e Gazetarëve Profesionalistë të Shqipërisë dhe Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë shpreh shqetësimin e indignatën e thellë për sulmin ...
Vijon në faqen 21

Dënojmë intimidimin e kryeministrit ndaj gazetarëve



EKSKLUZIVE

Denoncimi "bombë" i oficerit të Antidrogës

"Si ua shpërndanin shefat e policisë trafikantëve farën e kanabisit, merrnin 30%"

Antonio Nazeraj: "Bordi" bënte takime çdo muaj. Telefonata nga Tirana "më arrestoi"

Ish-agjenti i Antidrogës në Drejtorinë e Policisë Fier, Antonio Nazeraj në pjesën e dytë të intervistës dhënë për "Gazeta Shqiptare" tregon vijimin e situatës së vështirë që hasi pas denoncimit të Habilajve duke bërë një denoncim "bombë". Ai rrëfen se si ...
Në faqet 10-11

NEGOCIATAT PARA VOTIMIT, SI I MBLODHI MAXHORANCA 75 VOTA. JA DEPUTETET QE ABSTENUAN

TAHIRI NUK ARRESTOHET, SI U NDANE VOTAT NE KUVEND

Ish-ministri: S'pres ta gjej të drejtën këtu. Rama u përvishet gazetarëve: Bëni pyetje idiote. Opozita në revoltë: Qeveria tregoi veten. SHBA: Askush mbi ligjin



(Në foto) Kryeministri, Edi Rama, duke folur ndërkohë që deputetet e opozitës kanë braktisur sallën e parlamentit

SEKUESTRO DHE PASURISE

Pranga nipit të Arben Ndokës, plagosi aktivistin e LSI-së në zgjedhje
Në faqen 8

SHKURTIM MINIMAL

Administrata, ja vendet e punës që rrezikohen me skemën e re
Në faqen 12

LAJMI I FUNDIT

Shpërthim i fuqishëm në Burrel, tritol biznesmenit
Në faqen 8

HISTORI E LIDHJE

Pro terrorizmit, shqiptari e maqedonasi dëbohen nga Italia
Në faqen 13

UDHEZIMI



Masteri shkencor e profesional, ja lista me fituesit në secilën degë
Në faqet 16-19

Apostol Kosta tentoi të vetëvritet pas ngjarjes, por i shpëton vdekjes

Kushëriri vret burrë e grua për një mur

Historia e dashurisë së muzikantit me mësuesen, Serjani: Takimi i fundit

Nga BRIKENA METAJ & INA ALLKANJARI

Konflikti për një mur Këndarës mes banesave të dy familjeve ka shkakuar tragjedi në qytetin e Gjirokastrës. Burrë e grua janë ekzekutuar me breshëri kallashnikovi nga kushëri



dhe njëkohësisht fqinji i tyre, Apostol Kosta. 73-vjeçari ka pritur sapo çifti ka hapur dyert e banesës dhe krejt gjakftohtë ka qëlluar për vdekje 66-vjeçarin Aleko Kosta, muzikant i njohur në këtë qytet dhe bashkëshorten 49-vjeçare të këtij...
Në faqet 2-3

VRASJA E DYFISHTE

INTERVISTA

Humbi gjyqin për pronën, Apostol Kosta: Do e zgjidh në mënyrën time. Hodhi granatë në shtëpinë e viktimave

Kushërirri ekzekuton me kallash burrë dhe grua për një mur

73-vjeçari qëllloi në banesë muzikantin e mësuesen, tentoi vetëvrasjen

Brikena Metaj

GJIROKASTËR

Konflikti për një mur ndarës mes banesave të dy familjeve ka shkaktuar tragjedi në qytetin e Gjirokastrës. Burrë e grua janë ekzekutuar me breshëri kallashnikovi nga kushërirri dhe njëkohësisht fqinji i tyre, Apostol Kosta. 73-vjeçari ka pritur sapo çifti ka hapur dyert e banesës dhe kreu gjakftohtë ka qëlluar për vdekje 66-vjeçarin Aleko Kosta, muzikant i njohur në këtë qytet dhe bashkëshorten 49-vjeçare të këtij të fundit, Afërdita Kosta, me profesion mësuese. Më pas, autori i vrasjes ka tentuar të kryejë vetëvrasje, por ka mbetur i plagosur. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës bën me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur mëngjesin e djeshëm, rreth orës 07:25 në vendin e quajtur "Sokaku i të Marrëve", në lagjen Palorto. Krimat e armës kanë alarmuar banorët e qytetit muze dhe policinë, e cila ka mbërritur menjëherë në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Pas kryerjes së veprimeve hetimore parapra-prake, hetuesit e çështjes pohuan se ngjarja ka marrë shkas nga një konflikt pronësie. Mësohet se të hënën, gjykata e Gjirokastrës u kishte dhënë të drejtë çiftit Kosta. Ndërkaq, mësohet se ngjarja mund të kish të pasojë edhe më tragjike, pasi mësohet se fillimisht 73-vjeçari Apostol Kosta kishte tentuar t'i vriste me granatë, duke e hedhur në banesën e çiftit. E ndërsa, granata nuk ka shpërthyer, i moshuari ka marrë kallashin dhe i ka qëlluar duke i lënë të vdekur në vend.

NGJARJA

Tronditet Gjirokastra. Të shtënat me armë zjarri në lagjen "Palorto", shumë pranë shtëpisë muze të shkrimtarit të njohur Ismail



Viktima Aleko Kosta



Viktima Afërdita Kosta

"Jetonin në "Sokakun e të Marrëve", ky ishte gabimi i vetëm i çiftit të vrarë"

GJIROKASTER - Vrasja e dyfishtë e ndodhur dje në Gjirokastrë ka lënë pa fjalë edhe gazetarët në këtë qytet. Ata s'duan ta besojnë që girokastritët vrasin për një konflikt pronësie. Tëlnis Skuqi është njëri prej tyre dhe thotë se historitë të tilla nuk i ka ndodhur të raportonte në shumë vite punë. Ai thotë se gabimi i vetëm i çiftit Kosta është fakti që jetonin në "Sokakun e të marrëve", shumë afër banesës së shkrimtarit të njohur Ismail Kadare. Vrasje e dyfishtë në "Sokakun e të marrëve" "Kush ka pronë, ka luftë", do të shkruante Balzaku, shkrimtari francez. Një mësuese, si dhe një muzikant,



u vranë sot në lagjen "Palorto" për një gardh. Një ngjarje e paprecedent në Gjirokastrë. Për herë të parë në jetën time si gazetar po shkruaj një lajm të tillë. Gjirokastritët kurrë nuk vrasin për pronë. E tmerrshme, sepse gabimi i vetëm i viktimave ishte se ata

armë zjarri kushëririn e tij, Aleko Kosta dhe gruan e këtij të fundit. Gjithashtu, blutë thanë se autori i vrasjes së dyfishtë, pasi është siguruar që i ka vrarë bashkëshortët, ka tentuar t'i japë fund dhe jetës së tij, por ka

mbetur i plagosur rëndë (ka marrë një plumb në nofull dhe është shpërfytyruar). 73-vjeçari është dërguar menjëherë në spitalin e Gjirokastrës ku i është dhënë ndihma e parë mjekësore. Mjekët e këtij spitali pohuan se ai

GJYQI

Prej vitësh Aleko Kosta ishte në konflikt pronësie me kushëririn e tij Apostolin. Të dy sorollateshin gjyqve për të ndarë se kujt i përkisnin 4 m tokë që ndante banesat e tyre, e mbi të cilën ishte ngritur një mur rrethues. Ndërtimi i shkallëve nga ana e muzikantit të njohur në Gjirokastrë, ishte konsideruar si diçka e padrejtë nga djali i xhaxhait të tij e që nga ai moment s'kishin gjetur më paqe. Ndërkaq, pak ditë më parë, gjykata kishte vendosur në favor të dy viktimave.

ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Sipas policisë, në momentin e krimit, në banesë ka qenë dhe djali adoleshent i 49-vjeçares (nga martesa e parë), i cili është ngritur i tmerruar nga gjumi.

KONFLIKTI

Burime nga grupi hetimor dje deklaruan se vrasja e dyfishtë ka marrë shkas për motive pronësie. Prej vitësh Aleko Kosta ishte në konflikt pronësie me kushëririn e tij Apostolin. Të dy sorollateshin gjyqve për të ndarë se kujt i përkisnin 4 m tokë që ndante banesat e tyre, e mbi të cilën ishte ngritur një mur rrethues. Ndërtimi i shkallëve nga ana e muzikantit të njohur në Gjirokastrë, ishte konsideruar si diçka e padrejtë nga djali i xhaxhait të tij e që nga ai moment s'kishin gjetur më paqe. E ndërsa gjykata vendosi të hënën t'i japë të drejtë Alekos, Apostoli, një pensionist që gjithë jetën kishte punuar si shofer pranë spitalit të Gjirokastrës, kishte thënë vetëm dy fjalë: "Unë do t'i jap fund kësaj pune, do ta zgjidh me mënyrën time". Fjalëve të tij, nuk ia vuri askur veshin, e lanë të lirë. Dhe mëngjesin e djeshëm ai vrau kushëririn 66-vjeçar dhe bashkëshorten e këtij të fundit.



Vendi ku ndodhi vrasja e dyfishtë

DJALI



Si i shpëtoi sulmit me granatë e kallash 19-vjeçari Harri Kosta

GJIROKASTËR - Me shumë gjasa, ai që do vuajë më shumë ngjarjen tragjike që ndodhi ditën e djeshme në Gjirokastrë, kur Apostol Kosta qëllloi për vdekje djalin e xhaxhait të tij dhe gruan e këtij të fundit, është djali i çiftit Kosta, Harri. Në momentin, kur 73-vjeçari sulmoi me granatë dhe kallash Aleko dhe Afërdita Kostën në banesën e këtyre të fundit, 19-vjeçari ka qenë në gjumë dhe është zgjuar i tmerruar nga të shtënat. Për fat të mirë, ai doli pa dëmtime nga ky sulm që u mori jetën prindërve të tij. Harri (student në degën e Infermierisë në qytetin e Gjirokastrës) ishte djali i Afërditës nga martesa e parë. Ndërsa, pasi ishte martuar me Alekon, çifti nuk kishte fëmijë. I gjithë konflikti nisi për një mur rrethues në oborrin e kushërinjve Kosta.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Liaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotrotorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: http://www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPURË në "Klasik"Shpk



GJIROKASTËR - Çifti i bashkëshorteve Kosta nuk janë të panjohur në Gjirokastrë, burri një muzikant, kurse gruaja e ndjerë mësuese. Por, ata u bënë edhe personazhe publik, pasi në janar të vitit 2016 ishin pjesë e rubrikës "Ka një mesazh për ty" në emisionin e "TV KLAN", "E diela shqiptare", kur Afërdita i kërkoi bashkëshortit të saj, Aleko Kostës, t'i rikthehej dashurisë së tij të madhe; saksofonit. Pas një periudhe të gjatë emigracioni në Greqi, instrumentisti nga Gjirokastra tregoi se ishte dashur të shkëputej nga muzika dhe sado që tani përpigje, ndiente se nuk po kthehej dot të dashuria e tij e madhe. Por gjesti i bashkëshortes së tij, Afërditës, e cila kërkoi ta takonte të shoqin e saj të "E diela shqiptare", arriti

"U njohëm në një festë, ishte dashuri me shikim të parë"

Ja surpriza që mësuesja i bëri live burrit muzikant te "E diela shqiptare"



të jepte mesazhin, për të cilin ajo kishte sjellë saksofonin e tij nga Gjirokastra: "Ky saksofon është për ty shumë i shtrenjtë, por për mua akoma më shumë", -tha ajo. Atë ditë, Afërdita rrëfeu se ata ishin njohur në një festë, ku

ai po luante me bandën dhe se kishte qenë dashuri me shikim të parë. "Ai është shumë i pashëm", -tregoi Afërdita, "Imagjinoni një grua se cilës një burrë ia ngul sytë shumë gjatë. E pastaj, ajo shkon t'i kërkojë

që të luajë një valle për të". Kështu, ata ishin njohur e më pas kishin vendosur të martoheshin. Leko kishte pasur një martesë, ashtu sikurse Afërdita, e cila kishte edhe një djalë 18-vjeçar, Harin, me bashkëshortin e parë me të cilin ishin ndarë shumë miqësisht. Tani, siç tregonte ajo, i biri dhe bashkëshorti i saj i 2-të shkonin shumë mirë. E, në fakt, ishte i biri ai që ia kishte sjellë saksofonin në Tiranë, në mënyrë që ai të luante edhe një herë pas shumë kohësh për publikun. "Ajo është vajza ime e vogël"-tha Leko, sapo e pa që në anën tjetër të murit të "Ka një mesazh për ty", ishte Afërdita.

"Jemi të tronditur, është hera e parë që në Gjirokastrë ndodh një vrasje për pronar"

Ina Allkanjari

Vrasja e dyfishtë, Engjëll Seriani: Ja takimi i fundit me mikut tim, Kosta

"E gjeta te kafja e artistëve, folëm për muzikën"

Vrasja e bashkëshorteve Aleko dhe Afërdita Kosta jo vetëm ka tronditur, por edhe ka habitur tejet banorët e qytetit të Gjirokastrës. Sipas tyre, është hera e parë që në këtë qytet, një konflikt për çështje pronësie të arrijë deri në vrasje. Në lidhje me krimin e dyfishtë kanë reaguuar edhe gazetarë të qytetit të Gjirokastrës, të cilët i njihnin nga afër dy viktimit. "Jam shumë i prekur dhe ngela pa frymë kur e dëgjova për ngjarjen tragjike. Akoma s'e besoj që miku im Aleko nuk është më". Kështu tha dje gazetari i njohur, Engjëll Seriani, i cili vetëm tri ditë më parë ishte takuar me Aleko Kostën, i cili ishte pjesë e bandës muzikore të Bashkisë së Gjirokastrës. Seriani deklaroi se dy viktimat ishin njerëz të mirë, të qetë e të respektuar në të gjithë qytetin. Ndërkohë, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Engjëll Seriani tregoi me detaje takimin e fundit me mikun e tij muzikant, ndërsa u shpreh se ngjarja e rëndë i ka befusuar të gjithë. Kjo për faktin se ky qytet njihet për qytetari. "Në Gjirokastrë ka shumë konflikte pronësie dhe gjyqë pronësie, por asnjëherë tjetër nuk ka ndodhur që ato të degjenerojnë në ekstremitet. Ka ndodhur që palët në konflikt të jenë sharë apo rrahur, por jo deri në vrasje, siç ndodhi në rastin e bashkëshortëve Aleko dhe Afërdita Kosta. Më vjen shumë keq për këtë që ndodhi", tha gazetari Seriani.

Si u njohëm me lajmin



Gazetari Engjëll Seriani me muzikantin Aleko Kosta

NGJARJA

Vrasja e dy bashkëshortëve i ka befusuar të gjithë qytetarët. Sipas tyre, është hera e parë që në këtë qytet, një konflikt për çështje pronësie të arrijë deri në vrasje. Kjo për faktin se ky qytet njihet për qytetari.

tragjik për vrasjen e bashkëshortëve Kosta?

Vrasjen e mikut tim të shtrenjtë, Aleko dhe bashkëshortes së tij, Afërdita e dëgjova në media. Në orët e para të mëngjesit dëgjova për

largimin nga jeta të muzikantit dhe mikut tim të fëmijërisë njëkohësisht.

Si e pritën lajmin, ishit në dijeni të konfliktit të ndërjetit me kushëririn e tij?
Është një ngjarje

shokuese, jam shumë i prekur, akoma s'e besoj që miku im Aleko nuk është më. Ngela pa frymë kur e dëgjova lajmin. Nuk kam njohje për konfliktin, por sido që të ketë qenë, nuk meritonin një fund të tillë. Për më tepër mesa u tha edhe publikisht, konflikti ishte brenda familjes.

Kur e keni njohur muzikantin Kosta e si mund t'i përshkruani dy bashkëshortët?

E njihja që në fëmijëri, kemi qenë në një lagje. Kam shumë kujtime me të ndjerin Aleko, i cili do të mbetet një

VIKTIMAT

49-vjeçarja Afërdita Kosta ishte mësuese filloreje, nënë e një djali 19-vjeçar (nga martesë e parë), i cili ndodhej në shtëpi kur ndodhi ngjarja e rëndë. Ajo kishte rreth 5 vjet martesë me 66-vjeçarin Aleko Kosta, artist i njohur në qytetin e Gjirokastrës dhe me një eksperiencë 30-vjeçare në muzikë. Ai ka qenë pjesë e një zinxhiri të gjatë aktivitetesh simfonike, gjithashtu, ishte pjesë e bandës muzikore të bashkisë së Gjirokastrës.

juaj, Aleko Kosta?

Për Alekon mund të them se ishte një artist shumë i njohur dhe me një eksperiencë 30-vjeçare në muzikë. Ai ka qenë pjesë e një zinxhiri të gjatë aktivitetesh simfonike, gjithashtu ishte pjesë e bandës muzikore të Bashkisë së Gjirokastrës.

Kur ka qenë takimi juaj i fundit me të ndjerin?

Para 4 ditësh e takova mikun tim të shtrenjtë në një lokal afër kinoteatrit në Gjirokastrë, vend i cili konsiderohet si kafja e artistëve. E gjeje shumë shpesh në atë lokal. Në bisedën e fundit që ndava me të, Aleko më foli me përkushtim dhe pasion për profesionin e tij.

Si e pritën gjirokastritët ngjarjen e rëndë?

Vrasja e dy bashkëshortëve i ka befusuar të gjithë qytetarët. Sipas tyre, është hera e parë që në këtë qytet, një konflikt për çështje pronësie të arrijë deri në vrasje. Kjo për faktin se ky qytet njihet për qytetari.

A ka pasur më përpara në qytetin tuaj konflikte të kësaj natyre?

Në Gjirokastrë ka shumë konflikte pronësie dhe gjyqë pronësie, por asnjëherë tjetër nuk ka ndodhur që ato të degjenerojnë në ekstremitet. Ka ndodhur që palët në konflikt të jenë sharë apo rrahur, por jo deri në vrasje, siç ndodhi në rastin e bashkëshortëve Aleko dhe Afërdita Kosta. Më vjen shumë keq për këtë që ndodhi, jam shumë i prekur. Kjo është një humbje e pazvëndësueshme për familjarët dhe miqtë e tij.

Si u njoh Aleko me bashkëshorten e tij Afërdita?

Aleko u kthye nga emigracioni para 5-6 vitesh. Në këtë periudhë ai njohu zonjën Afërdita dhe të dy së bashku rigjetën jetën bashkëshortore. Ata gëzonin respekt dhe admirim nga të gjithë.

Prej sa kohësh e ushtronte këtë profesion miku

ÇESHTJA "TAHIRI" IMUNITETI

Protesta

Në momentin kur deputeti i PS, Tahiri mbajti një fjalë të shkurtër, demokratët ngritën parullat ku shkruhej, "Qeveri e krimit", "Qeveri mafioze". Një pankartë e tillë u la tek tavolina edhe kryeministrit Edi Rama me mbishkrimin "Qeveri mafioze".



BERISHA

"Parlamenti sot është i pushtuar fund e krye nga Habilajt. Një bandë që ka trafikuar me makinën e ministrit të Brendshëm dhe mjete të tjera 30 tonë drogë në Itali, ka nënshtruar totalisht dhe shndërruar në narko-mazhorancë Ramën e deputetët e PS. Nuk ka në historinë e këtij parlamenti ditë më të turpshme", -tha z.Berisha.



ALIBEAJ

Deputeti Alibeaj tha se, "Ligji nuk kërkon që Kuvendi të vërtetojë cilësinë e provave, s' duhet të kryejë proces të administrimit të provave, është pushtet ekskluziv i prokurorisë dhe gjykatës marrja, administrimi dhe vlerësimi i provave për të krijuar ato, nëse duhet ngritur akuzë dhe nëse i pandehuri duhet deklaruar fajtor apo jo".

"Qeveri mafioze", protesta e veçantë e demokratëve në Kuvend, i bashkohet edhe LSI

"Tahiri", Basha: Darka luksoze e dy deputetëve të PS, qeveria ka vdekur

Berisha: Rama shiti dëshmitarin e mbrojtur

Valentina Madani

Deputetët e PD-së zgjodhën dje një formë të veçantë për të protestuar në sallën e Kuvendit për arrestimin ose jo të ish-ministrit Tahiri. Në momentin kur deputeti i PS, Tahiri mbajti një fjalë të shkurtër, ata ngritën parullat ku shkruhej, "Qeveri e krimit", "Qeveri mafioze". Teksa deputetët e opozitës po akuzonin kryeministrin Rama për mbrojtje të krimit, pasi rrëzoi kërkesën e prokurorisë për heqjen e imunitetit të Tahirit, duke përfituar nga mungesa e kryeministrit i kanë lënë një pankartë Ramës të vendi i tij "Qeveri mafioze". Edhe LSI i është bashkuar protestës së PD në Kuvend me pankarta në duar kundër qeverisë. Në tavolinat e tyre, deputetët e LSI mbanin pankartat "Kundër krimit", "Jo drogës", "Kundër drogës". Pas rrëzimit të kërkesës së prokurorisë nga shumica për arrestimin e Tahirit, kreu i PD-së Lulzim Basha akuzoi Kryeministrin Rama si mbrojtës të krimit. Basha u shpreh se është hera e parë në historinë e pluralizmit politik në Shqipëri që rrëzohet kërkesa e prokurorisë për t'i hequr mandatin një deputeti. Ai për mëndsi se kur deputetët socialistë të Këshillit të Mandateve vendosën për të mos i hequr imunitetin Tahirit, darkuan në luks. "Kuvendi vendosi një rekord të zi, hera e parë që Kuvendi hedh poshtë kërkesën e prokurorisë për heqjen e imunitetit. 24 deputetëve Kuvendi u ka hequr imunitetin, të majtë dhe të djathtë, në pushtet dhe në opozitë, për akuzë të rënda, të lehta dhe qesharake. Por, arsyeja ka qenë e thjeshtë, me të mirat dhe të



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

AKUZA

"Kuvendi vendosi një rekord të zi, hera e parë që Kuvendi hedh poshtë kërkesën e prokurorisë për heqjen e imunitetit. 24 deputetëve Kuvendi u ka hequr imunitetin, të majtë dhe të djathtë, në pushtet dhe në opozitë, për akuzë të rënda, të lehta dhe qesharake", -tha Basha.

Imuniteti, Tahiri: Nuk pres ta gjej të drejtën në parlament

Ish-ministri i Brendshëm dhe deputeti i PS-së, Saimir Tahiri, deklaroi dje se mirëpret çdo vendim të parlamentit lidhur me imunitetin e tij dhe kërkesën e prokurorisë për arrestim, si të dyshuar për përfshirje në trafik droge dhe korupsionin e zyrtarëve të lartë. "Këtu janë betuar shumë për pafajësi, kështu që unë do jua kursej çdo fjalë timen



lidhur me këtë. Jam shumë i bindur se askush nga ju nuk ka kohë për të humbur, unë aq më pak. E mbi të

këqijta e tij, kanë respektuar parimin e i takon drejtësisë që të vendosë. Atë ditë kur deputetët socialistë votuan për mbrojtjen e Tahirit, dy miqtë e mi të huaj darkuan në një nga lokalitetet më luksoze të Tiranës. Për çudinë e tyre, por jo të timen, dy tavolina të vetme të zëna të lokalit kishin në krye so-

cialistë, njëri pinte puro të shtrenjta kubane dhe tjetri me verë që kushton me shtrenjtë se rroga minimale. Dy deputetë rrogarë që nuk e kishin parë këtë luks, sot jetojnë si sheikë, kjo është e vërteta e shtetit tënd. Sot me këtë votë keni mbrojtur veten tuaj, e kthyet trëndafilin e partisë në lule të hashash-

gjitha, unë nuk pres ta gjej të drejtën dhe të vërtetën time këtu në sallën e parlamentit, por aty ku më takon, para drejtësinë dhe të gjithë qytetarëve. Kështu që e mirëpres çdo vendim tuajin, cilido qoftë ai, rruga për të gjetur drejtësinë nuk ndalet dot", tha Tahiri. Ndërkohë që Tahiri fliste në Kuvend, deputetët e opozitës hapën pankarta me mbishkrimet "Qeveri mafioze", "Qeveri e krimit", "Qeveri e drogës" etj.

Kjo qeveri ka rënë, është e vdekur", deklaroi z.Basha. Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi kryeministrin Edi Rama se ka tradhtuar dëshmitarin e mbrojtur të prokurorisë në çështjen e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Lidhur me rrjedhjen e emrit të oficerit së policisë, e cila është para-



Opozita dje në seancën parlamentare

Droga



FLAMUR NOKA

Deputeti i PD-së, Flamur Noka bëri thirrje për revolucion popullor për të shpërruar organizatat kriminale: "Ky parlament demonstroi se është parlamenti i turpit. Sot ky parlament demonstroi se është parlamenti i drogës, sot në këtë parlament si në asnjë vend të botës u bë avokaturë ndaj krimit dhe drogës".

qitur si dëshmitare kundër Tahirit, Berisha tha se pas kësaj "gëndron vetëm një emër, Edvin Kristaq Habilaj, i cili pasi mori foton nga Blendi Habilaj, shkoi me vrap në zyrën e Fatmir Xhafajt dhe atje identifikuan personin, tradhtuan, duke shkelur sekretin më të rëndësishëm të shtetit". Kryetari i Parlamentit, Garmoz Ruçi i ndërpreu fjalën Berishës, me argumentimin se nuk është procedurë: "Të lutem ke ndërhyrë në mes të seancës, fjalën e ka Ulsi Manja". Më herët në një postim në rrjetet sociale, Berisha i bëri thirrje Prokurorisë së Përgjithshme që të nisë me urgjencë hetimin për Edi Ramën, që sipas ish-kryeministrit "tradhtoi dhe shiti dëshmitaren e mbrojtur dhe të gjithë ata që janë të implikuar në këtë krim të shëmtuar". Ndërsa, jashtë sallës së

Kuvendit, në një prononcim të shkurtër për gazetaret, Berisha tha se Kuvendi është pushtuar nga Habilajt. "Parlamenti sot është i pushtuar fund e krye nga Habilajt. Një bandë që ka trafikuar me makinën e ministrit të Brendshëm dhe mjete të tjera 30 tonë drogë në Itali ka nënshtruar totalisht dhe shndërruar në narko-mazhorancë Ramën e deputetët e PS. Nuk ka në historinë e këtij parlamenti ditë më të turpshme. Kjo është dita e turpit kombëtar të këtij parlamenti". Nga foltoja e Kuvendit të Shqipërisë, deputeti demokrat Enkelejd Alibeaj lexoi relacionin e opozitës, duke numëruar të gjitha arsyet se përse Kuvendi duhet të vendosë për heqjen e imunitetit të ish-ministrit Saimir Tahiri dhe të pranohet kërkesa e prokurorisë për arrestimin e tij.



KRYEMADHI

"Kam votuar pro kërkesës së prokurorisë. Kam votuar për të rinjtë dhe të rejtat që presin diçka. Votimi vërtetoi se krimi ka kapur maxhorancën. Vërtetoi që fjalët e Habilajve se 74 mandatet janë blerë me paratë e drogës, janë të vërteta. Sot jam e bindur se të rinjtë shqiptarë do t'i thonë jo drogës dhe kapjes së institucioneve", - u shpreh Kryemadhi.



BALLA

"Ne e kemi thënë shumë qartë ditën e hënë: Kolegu Saimir Tahiri nuk është më as anëtar i Grupit të PS; nuk është më as një funksionar në të gjitha funksionet strukturore të PS, por është një deputet i lirë, i cili përballë drejtësisë të mos ketë asnjë lloj mburoje politike. Ky është standardi që kemi vendosur", -tha Balla.



MANJA

Deputeti socialist Ulsi Manja u shpreh: "Mungesa e provave, nxitimi i organit të akuzës për heqjen e imunitetit për Tahirin krijon bindjen se në këtë stad të hetimeve prokuroria ka sfond dhe ngjyrimet politike. Kuvendi ka detyrimin të respektojë të drejtën e lirisë, e cila është një e drejtë që nuk mund të cenohet".

Negociatat para votimit, paralajmërimi i Ramës për opozitën: Do e paguani

Tahiri nuk arrestohet, maxhoranca "rrëzon" prokurorinë në Kuvend

Si votuan deputetët, PDIU bashkon votat me PS



Negociatat

Çështja "Tahiri" vuri në lëvizje deputetët e maxhorancës, të cilët u panë të lëvizin nga njëra tavolinë tek tjetra. Kreu i Grupit Socialist Balla u pa të bisedonte me deputeten e PDIU Reme Lala. Edhe kryeministri Rama u pa në situata të ndryshme, herë pas herë të sikletshme. Pranë tij u afruan disa herë ministra të ndryshëm, ndërsa vetë Rama foli me Kryetarin e Kuvendit Ruçi. Bashkim Fino, pas përfundimit të fjalës së Saimir Tahirit, është parë të bisedojë me deputetin jashtë ambienteve të parlamentit. Nga ana e saj, opozita PD dhe LSI zgjidhën të protestojnë në një mënyrë të veçantë, duke mbajtur në duar parulla me mbishkrimin: "Qeveri mafioze", "Jo drogës" etj.

Valentina Madani

Kuvendi votoi dje kundër kërkesës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda për dhënien e autorizimit për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Raporti i maxhorancës, që autorizon vetëm hetimin dhe kontrollin e banesës, por jo arrestimin e Tahirit, pasi sipas tyre prokuroria nuk ka prova të mjaftueshme për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, u votua me 75 vota pro dhe 60 vota kundër. Në seancë në momentin e votimit për imunitetin e Tahirit, nuk ishin vetë ish-ministri Tahiri, Tom Doshi, Vangjel Tavo, Agron Çela dhe ministri Fatmir Xhafaj. Nga 75 vota, 72 vota ishin të PS, (ka 74 mandate po mungon Tahiri dhe Xhafaj) dhe tri vota të PDIU bëjnë 75 votat. Ndërsa kundër ishte gjithë opozita përveç Tavos, Çelës dhe Doshit, që munguan. Para votimit deputetët socialistë u shfaqën të tensionuar ndërkohë që Edi Rama dhe Lulzim Basha u panë shpesh të bënin telefonata. Raporti i opozitës, i cili kërkonte heqjen e imunitetit dhe arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, pasi sipas saj ekzistojnë fakte të besueshme për përfshirjen e Saimir Tahirit në trafik droge, si dhe veprën penale korrupsion i zyrtarëve të lartë, u rrëzua pas votimit me 60 vota pro dhe 75 vota kundër. Deputetët e Partisë Demokratike u larguan nga salla e Kuvendit pas fjalës së kryetarit Lulzim Basha dhe në momentin që mori fjalën kryeministri Edi Rama. Rama paralajmëroi deputetët e opozitës se do ta pësojnë keq e më keq, duke menduar se po i bëjnë për



Kryeministri Edi Rama

PROKURORIA

Prokuroria për Krimet e Rënda ka ngritur dyshime se deputeti Saimir Tahiri ka konsumuar elementë të veprave penale të "Trafikut të narkotikëve, në bashkëpunim", kryer në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal dhe "Korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë".



budallenj shqiptarët. Sipas të parit të qeverisë, kjo derexhe është fatura që do të marrin opozitarët nga shqiptarët, pasi i kanë bërë këta të fundit për budallenj disa herë me radhë. "Për këtë, shtoi Rama teksa iu drejtohej deputetëve të PD, do paguani përsëri, do paguani dhe më keq, me kamatëvesesë shumë të lartë

AKUZA

Prokuroria për Krimet e Rënda iu drejtua Këshillit të Mandateve dhe Imuniteteve me kërkesën për heqjen e imunitetit të Tahirit, me qëllim arrestimin e tij, kontrollin personal dhe të banesës. Prokuroria tha se ka prova që e implikojnë atë me grupin e vëllezërve Habilaj.



për sjelljen, veprimet dhe fjalët e ulëta për Shqipërinë, njerëzit e drejtësinë". "O Selman i vëllait, kë të qaj më parë, ty a motrën tonë që u zu i njëjti hall. As kam kë qaj, as kam si ju qaj, për hir të të vërtetës, përveçse duke ju thënë këtu në sy diçka që ua kam thënë edhe më parë e që natyrisht vlen të përsëritet për ata që na dëg-

jojnë: Kush i bën shqiptarët për budallenj në fund e ha! Mos vazhdoni t'i bëni shqiptarët për budallenj, se keq e më keq do shkon dhe keq e më keq do paguani. Kush kujton se e bën për budalla shqiptarin më të pashkollë, gabon dhe në fund fare paguan. Keni gabuar më parë e keni gabuar edhe më vonë. Keq e më keq keni paguar", - deklaroi z.Rama. Kreu i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla, paralajmëroi deputetët e PD në lidhje me bojkotin e komisioneve parlamentare. Nga foltoja e Kuvendit, Balla tha se bojkoti është një vendim i lehtë kur e merr por i vështirë kur e ndërpret. Në lidhje me këtë, deputeti socialist iu kujtoi deputetëve opozitarë herën e fundit të bojkotit, duke thënë se i shpëtuan ata, por këtë radhë nuk do ta bëjnë më. "Së pari, z. Spaho, ju përgëzoj për sjelljen decente tuaj në këtë sallë, sot. Shpresoj që bojkotin e nisur të hënë e të martë ta ndërprisni, sepse besoj që nga dy bojkotet e tjera që keni marrë, keni mësuar që bojkoti është zgjidhja më e lehtë kur e merr dhe më e vështira për ta shpëtuar nga bojkoti. Të jeni të sigurt që nëse ikni kësaj radhe, nuk ju shpëtojme dot më nga asnjë lloj bojkoti që mund të bëni", - theksoi z.Balla. I menjëhershëm ishte reagimi i demokratit Edmond Spaho, i cili tha se ndjehet trishtueshëm, pasi në këtë seancë u vërtetua se kjo është qeveria e krimi. "Sot ndjehem shumë i trishtuar, sepse në këtë seancë u vërtetua se kjo është qeveria e krimi. Sot ju dha goditja më e rëndë reformës në drejtësi dhe se Rama e do atë për të luftuar kundërshtarët, për të mbrojtur kriminelët. Kjo tregon ku është katandisur Shqipëria", -tha Spaho.

HISTORIKU I DOSJES "HABILAJ" KU PËRMENDET DHE TAHIRI

1. Më 16 tetor mediat italiane njoftuan se një bandë italo-shqiptare e trafikut të drogës është shkatërruar në Catania, Itali, ndërsa 7 persona janë arrestuar. Në pranget e policisë kanë rënë 4 italianë dhe 3 shqiptarë, Maridian Sulaj, Moisi Habilaj dhe Fatmir Minaj, ndërsa 4 shqiptarë të tjerë janë në kërkim.
2. Pas këtij lajmi, kreu i demokratëve, Lulzim Basha denoncoi lidhjen e afërt të Saimir Tahirit me këtë bandë. Sipas tij, "Audi" i famshëm i ministrit përdoorej pikërisht nga Moisi Habilaj. Më pas edhe ish-kryeministri Sali Berisha tha se Tahiri ishte drejt arrestit ndërkombëtar.
3. Një ditë pas arrestimit të 7 anëtarëve të bandës italo-shqiptare që ka trafikuar dhjetëra ton marjuanë në Shqipëri dhe Sicili u zbuluan përgjimet e para që përfshijnë drejtpërdrejt Moisi Habilajn, vëllain e tij Artan Habilaj. Në këtë përgjim fitej edhe për përfilimet që kishte marrë Tahiri prej tyre.
4. Më pas vetë ish-ministri Tahiri në një konferencë të menjëhershme për mediat tha se është i gatshëm të hetohet dhe të dalë e vërteta. Ai pranoi gabimin me shtjetën e makinës Habilajve.
5. PD dhe LSI u bashkuan në një front kërkues largimin e Edi Ramës.
6. Prokuroria i kërkoi Kuvendit lejon për arrestimin e deputetit Saimir Tahiri.
7. Për dy ditë në Këshillin e Mandateve tre prokurorët e çështjes, Besim Hajdamataj, Elisabeta Imeraj dhe Gentian Osmani përballën akuzat me mbrojtjen e Saimir Tahirit. Të shtunën Këshilli doli me qëndrimin. PS lejoi vetëm kontrollin e banesës, ndalimin për të dalë jashtë vendit, por jo arrestimin, ndërsa PD e LSI u bashkuan me kërkesën e prokurorisë për arrestin e deputetit.
8. Të mërkurën, Kuvendi votoi me 75 vota pro, raportin e maxhorancës për të mos i dhënë prokurorisë mandatit të arrestojë Saimir Tahirin, por vetëm ta hetojë.

SULMI NDAJ GAZETAREVE KRYEMINISTRI

Kryeministri përplaset me reporterët, pas tensionit në sallën e Kuvendit

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama sulmoi dje ashpër gazetarët që e ndjekin atë në aktivitetin e përditshëm në parlament apo qeveri. Pas një seance të tensionuar, ku u votua dje për heqjen e imunitetit të deputetit Saimir Tahiri dhe dhënien e lejes prokurorisë ta hetojë, Rama duket se këtë tension ua kaloi reporterëve para sallës së seancave plenare. Sapo njëri prej tyre i bëri pyetjen se për pajafësinë apo jo të Saimir Tahirit duhet të vendoste gjykata, kryeministri iu përgjigj ashpër dhe duke e fyer: "Para se të bësh një pyetje kaq pa vend, shko e lexo dhe shko kupto se cili është roli i Kuvendit. E kuptoni që pyetjet tuaja burojnë nga padituria, s'është ndonjë problem të jesh i paditur, se s'keni për detyrë të dini gjëra që s'janë pjesë e formimit tuaj, por duhet të lexoni se kjo nuk është shkencë". Më tej, ndër- sa gazetarja e pyeti se çfarë komenti kishte për deklaratën e Bashës për dy deputetë socialistë që kanë ngrënë darka luksi, Rama iu përgjigj: "Jeni për të qarë hallin". Reagimit të gazetarit se ai duhet t'u kthejë përgjigje pyetjeve të tyre, Rama i tha: "Është detyra ime t'ju përgjigjem si ma do... e bardha zemër. Ju s'keni të drejtë të më kufizoni. Duhet të kuptoni se roli juaj nuk është për të amplifikuar thashethemet". E sërisht, ndër- sa u pyet nga gazetari se përse zgjodhi t'i ofendonte, kryeministri i tha: "S'po iu ofendoj fare se ju ulni e ngrini këdo si ju teket dhe kujtoni se askush s'ka të drejtë t'ju thotë që jeni pjesë e një kazani të madh, pjesë e problemit të Shqipërisë. Ju duhet t'i thërrisni mendjet, të lexoni dhe të kuptoni, ju këtu dhe ata atje që ju paguajnë juve". Një tjetër pyetje e bëre për kryeministrin ishte ajo për ndryshimet në Kushtetutë për imunitetin. "Kjo është një pyetje idiote dhe përgjigja ime për këtë pyetje idiote është që ne kemi Kushtetutën tonë", tha Rama, duke vijuar me fyerje. Pasi e kanë dëgjuar dhe kanë replikuar, gazetarët tërhoqën mikrofonat, duke u larguar para se të përfundonte kryeministri e duke e ndërprerë ata të parët komunikimin me kreun e qeverisë dje.

Rama fyen gazetarët: Jeni për të qarë hallin, pyetje idiote

Reagimi: Nuk kam fyer askënd, dhashë opinionin tim



Kryeministri Edi Rama, dje duke e folur për gazetarët

ASTRIT PATOZI

"Sipas meje, ka vetëm një mënyrë për t'u hakmarrë ndaj qeverive arrogante dhe të korruptuara. Të informosh çdo ditë, çdo orë dhe çdo minutë për të vërtetat përvëluese, që i nxjerrin ato zbuluar", - u sugjeroi dje Patozi gazetarëve, duke e cilësuar ngjarjen dje si një shfaqje të shëmtuar.

Seanca e djeshme parlamentare



Shoqata e gazetarëve reagojnë në unison pas fyerjeve të Ramës

Thirrja e Unionit të Gazetarëve: Bojkot aktivitetit të kryeministrit të premtën

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë e quajti të pabarueshme gjuhën dhe leksionet e kryeministrit për gazetarët dhe propozon për ta një bojkot të veprimitarisë së Kryeministrit gjatë ditës së premtë. "Deklarimet e zotit Edi Rama, kryeministër i Shqipërisë, drejtuar reporterëve të mediave të vendit janë një arrogancë në komunikim dhe fyerje e një përfaqësuesi të lartë politik dhe shtetëror ndaj gazetarëve në përgjithësi. Kryeministri i vendit në mënyrë të përsëritur



përdor publikisht etiketim fyes dhe injorues ndaj mediave të vendit dhe gazetarëve. Pohime të tilla dhe etikimet në fjalë përbëjnë një precedent të rrezikshëm

në marrëdhëniet mes dy pushteteve të njohura në jetën e sotme të shoqërisë, përkatësisht të ashtuquajturit pushtet ekuizetit dhe atij të medias", thuhet në deklaratën e Unionit të Gazetarëve. Duke e denoncuar këtë gjuhë, unioni vë në dukje edhe gjendjen kritike, në të cilën ndodhen gazetarët e sotëm në vend. Unioni i Gazetarëve shqiptarë propozon për gazetarët një bojkot të veprimitarisë së Kryeministrit ditën e premtë.

terrenit, po e kisha dhe kam me të gjithë ata që lirinë e pushtetit të medias janë mësuar ta përdorin si armë, për të 'vrrarë e prerë', pa teklif e as karar - dhe as kushdo tjetër, nuk më ndalon dot mua të shpreh opinionin tim", tha Rama.



Kryemadhi: Kryeministri i frikësuar, duhet reagim

Kryetarja e LSI-së, Moni Koka Kryemadhi, reagoi ashpër ndaj sjelljes së kryeministrit Edi Rama me gazetarët. Në një status në "Facebook", ajo u shpreh: "I frikësuar i madh Edi Rama, pasi akuzoi dhe sulmoi për tri ditë me radhë akuzat e prokurorisë dhe prokurorët, sot në mënyrë të paprecedentë sulmoi gazetarët, duke sharë dhe fyer në mënyrë të turpshme. Një kryeministër arrogant, që fuqinë e gjen tek mandatet e blera me paratë e krimin, sot shpalli si armiq dhe ata që për detyrë kanë t'i drejtojnë pyetje", tha Kryemadhi. "Nuk e kuptoj ku e gjen këtë guxim një kryeministër në largim, që ndoshta nën efektin e lëndëve narkotike shfryzë dufin dhe frikën para punonjësve të medias. Ai që u përpoq për ditë me radhë të intimidonte punën e prokurorisë, sot bëri të njëjtën gjë me gazetarët dhe median që nuk i shërbejnë atij", shkruan kryetarja e LSI-së. Ajo i bëri apel medias, organizatave të të drejtave të njeriut dhe trupit diplomatik në Tiranë të reagojnë.



Basha: Rama, sulm agresiv e banalitet rrugaçëror

Pas deklaratave të forta dhe fyese të kryeministrit ndaj gazetarëve jashtë parlamentit, kryetari i PD-së, Lulzim Basha e cilësoi një banalitet rrugaçëror reagimin e Ramës. "Sulmi agresiv, banalitet rrugaçëror dhe kërcënimet kundër gazetarëve faktikisht çekuilibrimin psikik që ka Edi Rama kur nuk arrin ta fshehtë të vërtetën tronditëse as nga vetja e tij. I marrë peng nga Saimir Tahiri dhe i kthyer në një lolo nga kriminelët që i diktojnë vendimarrjen politike, Edi Rama sot ka humbur çdo lloj illembri psikik dhe njerëzor, ndaj po ushtron dhunë verbale kundër çdokujt që i duket se sfidon pushtetin e tij", u shpreh kreu i PD-së. "Përgjigja më e mirë ndaj kësaj dhune është kuraja për të zbuluar dhe thënë të vërtetën. Sot shumë se kurrë, Shqipëria ka nevojë për të vërtetën dhe për kurajë përballë së keqes. Në betejën për liri, të drejta dhe dinjitetin në jemi të gjithë bashkë, unë dhe opozita jemi në krah të çdo gazetari kurajoz", tha ai.

REAGIMI

Kreu i qeverisë nuk u tërhoq nga pozicioni i tij, edhe pas kritikave që mori për këtë sjellje nga politikanët të opozitës dhe gazetarët. Në një status në rrjetin social, ai shkroi mbrëmë se nuk ka bërë asnjë ofendim, thjesht ka shprehur një opinion. "Fare! Nuk kam fyer askënd. Thjesht kam dhënë opinionin tim, për çka ata kanë bërë gjatë gjithë këtyre ditëve duke e dezinformuar pub-

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

"Apartament" me sip. 237.15 m², Nr. Pas. 4/208+1-31, Vol.30, Fq.147, ZK 8514, e ndodhur në Durrës. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sh.a. Cmimi me të cilin fillon ankandi është 71.719 Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 16.11.2017 ora 16.00 në adresën Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Për çdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

- "Trrali" me sip. 200 m² nga kjo ndërtesë 114 m².Nr. pasurie 9/584, Vol. 27, Faqe 87, ZK 8532 i ndodhur në Sheq i Madh, Fier. Pasuria është hipotekuar në favor të Bankes Alpha sh.a. Cmimi me të cilin fillon ankandi i është 54.400 Euro. Ankandi për do të zhvillohet datë 30.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- "Arë" me sip. 9.159 m².Nr. pasurie 117/37, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur në Sheq i Fier. Pasuria është hipotekuar në favor të Bankes Alpha sh.a. Cmimi me të cilin fillon ankandi i është 58.400 Euro. Ankandi për do të zhvillohet datë 30.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Për çdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al.

Zyra Përbarimore Kozeta Caka njofton shpalljen e ankandit të për shijen e Pasurisë së Palajshme të lloji are. me Nr. 1/01, të ndodhur në ZK 2947, vol. 3, fq. 94, me sipërfaqe 400 m², Petrol, Tirane, në pronësi të diktorit Ismail Gjata. Ankandi fillon me cmim fillestar 1.713.256 leke. Ankandi do të zhvillohet në datë 07.11.2017, ditën e martë, ora 15:30 - 16:30, pranë Zyres Përbarimore Kozeta Caka në adresën: Bulevardi "Bijlart Curri", Pallati "Palma e Artë", Kati 1, Nr. 22, Tirane. Të interesuarit të kontaktojnë në Tel: +355 44532280.



Zv.ndihmës Sekretari i SHBA: Mbështesim prokurorët dhe gjykatësit

"Tahiri", Hoyt Yee: Askush mbi ligjin, qeveria të japë shembull

"Individët s'duhet të shënjestrohen pse i takojnë një partie"

Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Hoyt Brian Yee u pyet dje nga "Zëri i Amerikës" për çështjen ku është përfshirë emri i ish-ministrit Saimir Tahiri. Ai tha se ligji duhet zbatuar njësoj për të gjithë, se askush nuk mund të ketë imunitet dhe se individët nuk duhet të vihen në shënjestër pse i përkasin një partie a një tjetre, por qeveria - shtoi ai - duhet të japë shembullin se është seriozisht e angazhuar për të luftuar korrupsionin. Sekretari amerikan i bëri thirrje qeverisë së Kosovës që të ratifikojë marrëveshjen e kufirit me Malin e Zi dhe të hapë rrugën përfitimeve që do të kishin qytetarët, duke lëvizur pa viza në Evropë. Në një intervistë me korrespondentin tonë në Prishtinë, Leonat Shehu, ai ritheksoi se Serbia nuk mund të qëndrojë e ulur në dy karrige, por duhet të bëjë të qartë zgjedhjet strategjike të saj.



Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Hoyt Brian Yee

Më lejoni të them se jemi shumë të kënaqur me përpunimin që Shqipëria ka arritur dhe jemi të kënaqur që Shtetet e Bashkuara kanë pasur mundësinë të kontribuojnë në reformat, përfshirë këtu edhe reformat në drejtësi. Bashkërisht me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara kanë ndihmuar Shqipërinë të miratojë legjislacionin, të miratojë ndryshimet kushtetuese, me synimin që të forcojë sistemin e drejtësisë. Dhe kjo për faktin se një gjë e tillë nuk është e rëndësishme vetëm për sundimin e ligjit në Shqipëri dhe për kushtet në të cilat jetojnë qytetarët e saj, por edhe për faktin se reformat janë një nga kushtet kryesore për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Dhe pikërisht në këtë frymë, ne kemi vazhduar të mbështesim përpjekjet e Shqipërisë për të zbatuar reformat në sundimin e ligjit dhe po ashtu, edhe në luftën kundër krimit, kundër krimit të organizuar, kundër korrupsionit.

VLERËSIMI

"Jemi shumë të kënaqur me përpunimin që Shqipëria ka arritur dhe jemi të kënaqur që Shtetet e Bashkuara kanë pasur mundësinë të kontribuojnë në reforma, përfshirë këtu edhe reformat në drejtësi. Bashkërisht me BE-në, edhe SHBA-të e kanë ndihmuar Shqipërinë të miratojë legjislacionin, të miratojë ndryshimet kushtetuese, me synimin që të forcojë sistemin e drejtësisë", - tha Yee.

RASTI "TAHIRI"

"Ligji duhet të jetë i zbatueshëm për të gjithë njësoj, askush nuk duhet të jetë mbi ligjin, askush nuk mund të gëzojë imunitet nga ligji", u shpreh dje zv.ndihmës Sekretari amerikan i Shtetit.

Qeveria e brishtë e Kosovës përballat me sfida të mëdha për trajtimin e disa çështjeve të ndjeshme, duke përfshirë edhe shënimin e kufirit me Malin e Zi. Kryeministri i ri Haradinaj ka kundërshtuar marrëveshjen në të kaluarën. A ka ndonjë mënyrë për të dalë nga kjo situatë pa miratimin e marrëveshjes në parlament?

Së pari, dua të them se Kosova ka një numër mundësish të rëndësishme me të cilat përballat e që mund të përmbushen vitin e ardhshëm, apo mbase edhe më herët. Një nga këto mundësi është marrëveshja e shënimit të kufirit, që tashmë është nënshkruar me Malin e Zi. E di nga kolegët e Bashkimit Evropian se marrëveshja për kufirin, sapo të ratifikohet, do të zhblikojë rrugën e Kosovës drejt udhëtimit pa viza në Bashkimin Evropian. Kjo besojmë është jashtëzakonisht e rëndësishme për njerëzit e Kosovës, që t'u tregohet se janë pjesë e Evropës, nuk janë të izoluar, janë të mirëseardhur në Evropë dhe do t'u japë shumë shpresa, shumë kurajë atyre në qeveri dhe jashtë saj se puna që bëjnë, se reformat që bëjnë, vendimet e vështira që marrin, në fakt shpagaheun. Pra, ne e inkurajojmë qeverinë e Kosovës që të shfrytëzojë këtë mundësi, aty ku qeveria e fundit nuk ishte në gjendje. Ta shfrytëzojë dhe ta ratifikojë marrëveshjen në parlament dhe të përfutojë, me pëlqimin e Bashkimit Evropian, nga udhëtimi pa viza. Ne besojmë se është

e mundur. E kuptojmë që marrëveshjet si kjo, çështjet që përfshijnë kufijtë, marrëdhëniet me fqinjët, janë nganjëherë të ndërlikuara. Para se të vinit në Prishtinë, kenel qenë në Beograd ku keni deklaruar se Serbia nuk mund të ulët në dy karrige, vëganërisht në ato karrige janë shumë larg. A është kjo një shenjë e ndryshimit në politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara? A do të ushtroni më shumë trysni mbi Serbinë në të ardhmen për të "zgjedhur anë"?

Ajo që kam thënë, me serbishten time jo të përsosur, duke cituar një provë të vjetër serb, se nuk mund të uletsh njëkohësisht në dy karrige. Është e mundur të uletsh një gjë të tillë njëkohësisht, është shumë e vështirë. Çështja është se për një vend siç është Serbia, ose për cillind vend tjetër që synon t'i bashkohet Bashkimit Evropian, NATO-s, është me rëndësi që ai vend të jetë plotësisht i përkushtuar ndaj atij synimi. Jo përkushtim vetëm me fjalë, por me vepra, duke investuar, duke investuar kohë. Edhe Kosova ka vendime të ngjashme për të bërë. A është Kosova 100 për qind e përkushtuar që të normalizojë raportet me Serbinë, a është 100 për qind e përkushtuar t'i bashkohet BE-së? Të gjitha qeveritë përballen me këto zgjedhje. Mesazhi im për Serbinë ish-

te që nëse është duke punuar drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian, atëherë duhet të përqendrohet në reformat e nevojshme, në mënyrë që ta arrijë integrimin në BE. Ne nuk i kundërshtojmë lidhjet që Rusia ka me Serbinë, natyrisht që Rusia do të ketë gjithmonë lidhje me Serbinë. Të dyja vendet kanë lidhje historike, kulturore, fetare, ekonomike. Nuk jemi kundër kësaj. Edhe Shtetet e Bashkuara kanë lidhje me Rusinë, lidhje tregtare, kemi bashkëpunim politik. Pikëpamja jonë është se aty ku interesat tona janë të ngjashme me ato të Rusisë, ne do të bashkëpunojmë me Rusinë, si për shembull lufta kundër terrorizmit, mbase në Siri dhe janë edhe fusha të tjera bashkëpunimi. Ne duam gjithashtu që Serbia të jetë në gjendje të bashkëpunojë me Rusinë, aty ku interesat janë të njëjta. Por, gjithashtu besojmë se aty ku interesat tona ndahen, aty ku ne synojmë të bëjmë në fakt gjëra të ndryshme mes nesh, aty ku vizonet tona dallojnë shumë, atëherë ne, Shtetet e Bashkuara, duhet të mbrojmë interesat, vlerat dhe parimet tona dhe të atyre që janë aleatë tanë.

Në Shqipëri, një ish-ministër i Brendshëm, akuzohet për lidhje me një grup trafikimi drogë. Cila është pikëpamja juaj për mënyrën se si po trajtohet çështja e tij?

Të gjitha këto shërbejnë për të ngritur standardin jetësor për qytetarët e Shqipërisë, por edhe për ta ndihmuar përpunimin e Shqipërisë drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Së këndejmi, jemi duke ofruar drejtëpërdrejtë ndihmën tonë, ekspertizën teknike, ndihmën financiare në ndërtimin e strukturave, në trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve, për t'u ndihmuar që të kryejnë punën e tyre. Singërisht, nuk mund të flas dot mbi rastet individuale, ekspertizën besojmë në disa parime.

I pari është se ligji duhet të jetë i zbatueshëm për të gjithë njësoj, askush nuk duhet të jetë mbi ligjin, askush nuk mund të gëzojë imunitet nga ligji. Mbështesim plotësisht prokurorët dhe gjykatësit, të cilët ndjekin hetimet, dënimet, kudo që ato çojnë, në nivele të larta apo të mëposhtme të administratës. Nuk besojmë se individët duhet të shënjestrohen pse i takojnë një partie politike apo një tjetre, por parimi themelor është se askush nuk duhet të jetë mbi ligjin. Së dyti, ne mbështesim qeverinë që jep shembullin. Qeveria është ajo, e cila duhet të japë shembullin dhe të demonstrojë para qytetarëve se është e përkushtuar të luftojë korrupsionin, qofshin ata qytetarë, zyrtarë qeveritarë, të huaj, shqiptarë dhe se Shqipëria është serioze në përpjekjet e saj për të luftuar korrupsionin.



"Drejhtësia", Glos: Po ndërmerren dy standarde për politikanët dhe qytetarët

Zhvillimet e fundit në Shqipëri janë ndjekur me interes edhe nga ekspertët gjermanë në fushën e drejtësisë. Shefi i zyrës së fondacionit "Konrad Adenauer", Walter Glos, tha se politikanët e korruptuar duhet t'i drejtohen gjykatës për të provuar pafajësinë e tyre. Deklaratat u bënë në një tryezë për ecurinë e reformës, ku ekspertët gjermanë të drejtësisë thonë se reformimi i drejtësisë në Shqipëri po vonohet dhe se progresi nuk është bindës. Ndërkohë që në parlament mazhoranca rrëzoi kërkesën e prokurorisë për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, jo shumë larg këtij institucioni, shefi i zyrës së fondacionit gjerman "Konrad Adenauer" adresoi një mesazh të fortë për politikanët e korruptuar. Sipas Walter Glos, ekspert për reformën në drejtësi tha se vendi për të provuar fajësinë apo pafajësinë e një politikanit është gjykata dhe se ai nuk duhet të mbrohet përmes imunitetit. "Populli e do më shumë reformën në drejtësi se sa politika, vendimmarrësit duhet të mos e pengojnë këtë proces, por ta nxisin atë. Kur të shohim sukses të reformës, do të hapim dritën jeshile për çeljen e negociatave. Ndërkohë, mirëpresim konsensus me partive. Nisur me zhvillimet e fundit duhet të them se po ndërmerren dy standarde për politikanët dhe qytetarët. Nëse ka politikanë të korruptuar, vendi për të provuar pafajësinë apo fajësinë është në gjykatë", tha Glos. Ish-drejtuari i misionit EURALIUS, Rainer Deville, tha se ka vonesë në implementimin e reformës dhe tha se progresi i bërë nuk është bindës. "Procesi ka një vit vonesë dhe nuk ka filluar ende si duhet, edhe pse tani duhet të ishte drejt fundit. Kini parasysh se kjo reformë nuk i përket vetëm një partie, kjo i përket gjithë politikës dhe qytetarëve", tha Deville.

Prangosen dhe 8 persona të tjerë. Të "fortëve" të Lezhës u sekuestrohen 872 mijë euro pasuri kriminale

Arrestohet nipi i ish-deputetit Arben Ndoka, plagosi në zgjedhje aktivistin e LSI-së

Danjan Ndoka ishte në kërkim që prej vitit 2014

LEZHË

Danjan Ndoka, nipi i ish-deputetit socialist Arben Ndoka u arrestua ditën e djeshme nga policia e Lezhës në bashkëpunim me forcat RENE. 20-vjeçari akuzohet ditën e zgjedhjeve, më 25 qershor të këtij viti plagosi Florian Dushkun, aktivist i LSI-së. Mësohet se i riu ka qenë në kërkim që prej 3 vjetësh, pasi ndaj tij ishte vendosur masa e arrestit me burg për tre vepra penale. Lajmi për arrestimin e Ndokës u bë me dije mbrëmë për mediat nga drejtori i policisë së Lezhës, Bledar Çeliku. Ky i fundit pohoi se gjatë operacionit u arrestuar edhe persona të tjerë, si dhe u sekuestruan drogë, armë dhe pasuri që dyshohet se vjen nga aktivitetet kriminale të cilat kapin shumën prej 872 mijë euro.

ARRESTIMI

Policia e Lezhës dhe RENEA më në fund dje vunë në pranga Danjan Ndokën, lindur dhe banues në këtë qytet. Në momentin e ndalimit nga forcat policore, 20-vjeçarit iu gjet dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale një pistoletë e markës SMITH WESSON me 6 fishekë. "Për këtë shtetas, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me Vendimin Penal datë 20.10.2014, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale "Vrasje me dashje kryer në bashkëpunim mbetur në tentativë", "Plagosje e rëndë me dashje", "Armëmbajtje pa leje", parashikuar nga nenet 76,22,25, 278/2 të Kodit Penal. Kjo masë siguri e vendosur pasi më datë 16.09.2014, në afërsi të Katedrales së qytetit të Lezhës, në bashkëpunim me persona të tjerë ka tentuar të vrasë shtetasin F.N.", sqaroi Bledar Çeliku. Po ashtu, ky i fundit theksoi se Danjan Ndoka, me Vendimin Penal datë 28.06.2017. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale "Kanosje apo dhunim ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje", "Prodhimi dhe mbajtje pa leje e armëve të zjarrit dhe municionit" dhe "Plagosje e lehtë me dashje". Kjo masë siguri është vendosur pasi, më datë 25.06.2017, në qytetin e Shëngjinit, përpara lokal "Detarit", ka kanosur dhe dhunuar shtetasin Florian Dushku. Gjithashtu, ai është i dyshuar edhe për ngjarjen e datës 22.05.2017, ku pas një konflikti për motive të dobëta me një shtetas ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të gomave të mjetit tip fuoristradë Range Rover, me drejtues shtetasin B.L.

OPERACIONI

Në kuadër të operacionit "Vjeshtë 2017", nga strukturat e Drejtorisë Vendore të



Momenti i arrestimit të 20-vjeçarit Ndoka

Policisë Lezhë, janë referuar materiale për pastrim të produkteve të veprës penale në ngarkim të 30 shtetaseve. Konkretisht, drejtori i policisë së Lezhës tha se janë referuar në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë 14 raste të hetimeve pasurore; janë referuar në Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore Lezhë dhe Kurbin 15 raste të veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale". Në bazë të këtyre referimeve, gjykatat kanë vendosur sekuestru preventivë

për pasuri të dyshuara se kanë rrjedhur nga veprimtaria kriminal, të cilat kapin shumën prej 872 mijë euro. Pasuritë e vëna nën sekuestru preventivë janë: godinë banimi 3 kate, bar kafe; 4 apartamente banimi; 4 automjete luksoze; 1 llogari bankare prej 41.000 euro; 1 sipërfaqe tokë pemtore prej 15.000 m². Të gjitha këto referime janë bërë duke u mbështetur mbi dënimet e dhëna në kohë të ndryshme nga gjykata të huaja dhe vendase për veprat penale të

"Shfrytëzimit të prostitucionit", "Trafikimit të lëndëve narkotike", "Pjesëmarrjes në organizata kriminale". Gjithashtu, puna policore ka vijuar në goditje të veprimtarive të ndryshme kriminale si narkotikëve dhe armëmbajtje pa leje, duke u finalizuar me operacionet policore: "Miloti", "Deltar" dhe "Kolsh" ku është bërë e mundur arrestimi në flagrancë i 8 personave dhe 2 të tjerë shpallur në kërkim për veprat penale të "Prodhimit dhe shitjes së

Policia e Lezhës dhe RENEA më në fund dje vunë në pranga Danjan Ndokën, lindur dhe banues në këtë qytet. Në momentin e ndalimit nga forcat policore, 20-vjeçarit iu gjet dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale një pistoletë e markës 'SMITH WESSON' me 6 fishekë.

kg lëndë narkotike kanabis sativa dhe 1 armë zjarri pistoletë e markës Glock me 27 fishekë. Në lidhje me këtë rast, janë arrestuar në flagrancë 2 shtetas si posedues të lëndës narkotike dhe të armës së zjarrit. Sipas drejtorit, objektivi i këtij plan operacioni kanë qenë edhe personat në kërkim ku: janë ndaluar 10 shtetas të shpallur në kërkim për vepra të rënda penale ndaj të cilëve prokuroria kishte lëshuar urdhrat e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës: janë ndaluar 2 shtetas të shpallur në kërkim për veprën penale të "Vrasjes në bashkëpunim" në operacionin policor "One Year"; është ndaluar një shtetas e shpallur në kërkim për veprën penale të "Vrasjes së mbetur në tentativë"; në bashkëpunim me Z.Q.K. Interpol është ekstraduar nga Italia dhe bërë ndalimi i një shtetasi i dënuar me 3.5 vjet burg për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje; janë ndaluar 2 persona në kërkim për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike; janë ndaluar 4 persona të shpallur në kërkim për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike.

lendeve narkotike", "Kultivimit të bimëve narkotike". Gjatë këtyre operacioneve është sekuestruar një sasi prej: 385.5 kg lëndë narkotike kanabis sativa; 80 fara bime narkotike; 12 automjete; 10 celularë; 1 armë gjahu dhe janë asgjësuar 468 bimë narkotike.

KONTROLLET

Drejtori i Policisë së Lezhës tha dje se në bashkëpunim me F.N.Sh-në Shkodër, në datat 20-21.10.2017, janë kryer kontrole ku si rezultat janë sekuestruar 4

SHKURT

E zë masivi i gurëve, humb tragjikisht jetën minatori

BULQIZË - Një minator ka humbur dje jetën në minierën e Bulqizës. Bëhet fjalë për 33-vjeçarin Eris Keta, i cili ishte duke punuar kur e ka zënë poshtë një masiv gurësh. Sipas burimeve policore, ngjarja e rëndë është shënuar në zonën D të minierës. "Sot (dje) rreth orës

09:15, policia u njoftua se ishte dërguar në spitalin Bulqizës, një shtetas pa shenja jete, punëtor në minierën e kromit. Shërbimet e policisë dhe grupi hetimor shkuan në ambientet e spitalit dhe në vendin e ngjarjes, ku kanë konstatuar se në ambientet e brendshme të një galerie kromi, në zonën D, shtetas E.K., 30 vjeç, banues në Bulqizë (punëtor në galeri), duke punuar dyshohet se e ka zënë poshtë një masiv gurësh i shembur e pasojë ka humbur jetën. Grupi hetimor vijon hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje", thuhej në njoftimin e policisë.



Eksploziv mobilierisë në Burrel, dëmtohen makinat e biznesmenit

BURREL - Një shpërthim i fuqishëm me tritol ka tronditur mbrëmë qytetin e Burrelit. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ngjarja ndodhi në lagjen "Drita". Mësohet se nga shpërthimi janë dëmtuar dy automjete në pronësi të biznesmenit F.B., banues në këtë qytet. Sipas bluve, dyshohet se lënda shpërthyes është hedhur nga jashtë rrethimit të mobilierisë, biznes që ishte në pronësi të 50-vjeçarit. Ndërkohë, përveç mjete të dëmtuara, nga shpërthimi janë thyer xhamat e banesave aty pranë. Fatmirësisht, nuk ka pasur persona të lënduar: "Rreth orës 21.00, Policia e Komisarariatit Mat, ka marrë njoftim se në hyrje të qytetit të Burrelit, pranë një mjete është



Vendi ku ndodhi shpërthimi

hedhur dhe ka shpërthyer një sasi lëndë plasëse. Menjëherë kanë shkuar shërbimet e policisë dhe grupi hetimor në vendin e ngjarjes ku kanë konstatuar se në oborrin pranë një mobilierie, ka qenë i parkuar një automjet tip "Land Rover", ku pranë këtij automjeti dyshohet se është hedhur dhe ka shpër-

thyer një sasi lëndë plasëse, duke u dëmtuar pjesërisht. Automjeti është në pronësi të shtetasit F.B., rreth 50 vjeç, banues në Burrel. Grupi hetimor ndodhet në vendin e ngjarjes ku po vijojnë hetimet për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë.

Sekuestrohet një automatik

U kapen me rreth 500 bimë kanabisi, arrestohen dy persona

Dy persona janë arrestuar nga policia ndërsa iu sekuestrua një sasi kanabisi, si dhe armë zjarri. Burime zyrtare të policisë bënë me dije se të arrestuarit janë shtetasit FN, 32 vjeç, banues në Markatoma, njësia administrative Zejmen, Lezhë dhe PGJ, 26 vjeç, banues në Zejmen, Lezhë. Vënia e tyre në pranga u bë nga strukturat e Sektorit Kundër Trafiqeve dhe Narko-

tikëve në Drejtorinë Vendore Shkodër, në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Pukë dhe Repartin FNSH Shkodër në bazë të Planit Operacional për kontrollin e territorit. Drejtori i policisë së Shkodrës, Gjovalin Lokaj tha dje se gjatë kontrollit të ushtruar në territorin e fshatit Gjegjan u konstatuan të kultivuara 473 bimë narkotike kanabisi sativa. Ndërsa, në afërsi të parcelës së mbjellë u gjetën



dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, në proces tharje, disa bimë kanabisi, bashkë me 2 thasë me peshë totale 50 kg lëndë narkotike. Gjithashtu, forcat policore gjatë kontrollit të ushtruar në ambientet përreth, gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri automatik.

Zbulohet magazina në Sukth ku prodhoheshin ushqime të falsifikuara

DURRËS - Një magazinë e falsifikimit të produkteve të ndryshme ushqimore është zbuluar dje në njësinë administrative Sukth. Magazina përdorej për të falsifikuar një sërë ushqimesh, si salcë, turshi, komposto, uthull, etj. Mësohet se bëhet fjalë për një magazinë ku falsifikoheshin lloje të ndryshme produkte ushqimore. Një pjesë e produkteve merreshin të gatshme dhe u vihej etiketa false, ndërsa mësohet se në magazinë prodhohej vetëm vaj ulliri. Gjatë inspektimit në këtë njësi, ish-



tori deklaroi se ka për qëllim dhe detyrë vendosjen e bazave për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe popullatës. "Gjatë inspektimit në njësinë administrative Sukth, u gjet një magazinë e tipit stallë, ku bëhej falsifikimi i produkteve të ndryshme ushqimore. Këto produkte etiketoheshin me etiketa false. Unë jam këtu për të vepruar sipas ligjit dhe për të menduar për shëndetin publik, që është pjesa më e rëndësishme e institucionit të cilin përfaqësoj", - tha drejtori i AKU.

Avokatët mbrojtës të të pandehurit do apelojnë vendimin

Skandali CEZ-DIA, gjykata dënon Kastriot Ismailajn me 11 vjet burg

I sekuestrohen rreth 4 milionë dollarë

Gjykata e Tiranës ka dënuar me 11 vjet burg ish-administratorin e DIA, Kastriot Ismailaj, i akuzuar për një skemë mashtrimi me mbledhjen e borxheve të CEZ-it. Bëhet fjalë për skandalin e bërë publik dy vjet më parë CEZ-DIA, i cili ngriti peshë politiken shqiptare e jo vetëm. Në seancën me dyer të mbyllura, e cila zgjati rreth 3 orë, u lexuan konkluzionet e mbrojtjes nga një avokat kryesisht. Kjo u kundërshtua nga biznesmeni, pasi dy mbrojtësit e tij ligjorë nuk ishin paraqitur dhe për këtë arsye kërkoi shtyrjen e seancës, por kërkesa u refuzua nga gjykata.

Gjithashtu, gjykata vendosi të sekuestronjë rreth 4 milionë dollarë të Kastriot Ismailaj dhe kalimin e tyre në favor të shtetit. Prokuroria pati kërkuar 15 vjet burg për të pandehurin, i cili kish të ngritur një skemë mashtrimi me mbledhjen e borxheve të kompanisë CEZ. Ndërkaq, dy ditë më parë Ismailaj kërkoi që të rihapej hetimi pasi dispononte 100 prova të reja, por kjo kërkesë u rrëzua nga gjykata. Avokatia e caktuar kryesisht nga gjykata, lexoi argumentet prej 34 faqesh të mbrojtjes, duke pretenduar për pafajësi për biznesmenin, duke ar-



Ish-administratori në DIA, Kastriot Ismailaj

gumentuar që prokuroria ka bërë një punë të dobët në provimin e akuzave dhe se gjithçka ndaj tij është politike, e pabazuar në prova dhe në fakte. Avokatja Elona Ullorja u përpoq të argumenton-

te se kalkulimet e bëra nga prokuroria në lidhje me borxhet e dëmet shkaktuar shtetit shqiptar janë abuzive dhe jo të drejta, dhe sipas prokuroria ka ngritur një akuzë të pabazë ndaj Kastri-

ot Ismailaj. Ndërkaq, sipas verdiktit të gjykatës së Tiranës, janë sekuestruar dhe kanë kaluar në llogaritë e shtetit; 3 milionë dollarë; 451 mijë euro; 939 mijë dollarë dhe 12 milionë lekë reja. Bi-

SEKUESTRIMI	
3 milionë dollarë	
451 mijë euro	
939 mijë dollarë	
12 milion lekë reja	

znesmeni Kastriot Ismailaj u cilësua fajtor për veprën penale "Mashtrim me pasojë të rëndë kryer në bashkëpunim" dhe "Pastrim të parave kryer me shumë se një herë". Ndërkohë, avokatët mbrojtës të Ismailaj, Vladimir Meçi, Alban Qafa dhe Elona Ullorja, kanë paralajmëruar se do ankmojnë në Gjykatën e Apelit vendimin e Shkallës së Parë, për të kërkuar lirimin nga akuzat të klientit të tyre.

SHKURT



Ministri Fatmir Xhafaj takohet me homologun italian

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj zhvilloi një takim me homologun e tij Italian, Marco Minniti. Në thelb të bisedës mes tyre ka qenë forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dypalësh e rajonal në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, si dhe masat kundër migracionit të paligjshëm. Në takimin që ministri Xhafaj zhvilloi me zv/prokurorin Antimafia Del Prete, mori mbështetje për ngritjen e Qendrës Rajonale të Bashkëpunimit Policor, për të koordinuar shkëmbimin e informacionit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, trafikuar e drogës, migracionin e paligjshëm etj.

Aksidenti i rëndë në Tiranë, fugoni përplas të miturin

TIRANË - Një aksident i rëndë ndodhi mbrëmjen e djeshme në kryeqytet, te Rruga e Qelqit në Kombinat. Mësohet se një furgon mallrash ka përplasur një femijë 6 vjeç. Menjëherë pas aksidentit të rëndë, i mituri u dërgua me urgjencë në Spitalin e Traumës ku ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore. Ndërkaq, uniformat blu të mbërritura në vendin e ngjarjes bënë shoqërimin e shoferit të mjetit, ndërsa grupi hetimor nisi punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Ekstradohet nga Skocia i dënuari me 17 vjet burg për vrasje

Një 47-vjeçar nga Vora është ekstraduar nga Skocia, pasi ishte shpallur në kërkim për një vrasje të ndodhur mbi 20 vjet më parë. Bëhet fjalë për shtetasin Astrit Picari, i cili është dënuar me 17 vjet burg për "Vrasje me dashje". "Shtetasi në kërkim ndërkombëtar Astrit Picari u ekstradua nga Edinburg/Skoci dhe

iu dorëzua Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr 532, datë 20.11.1997 e ka dënuar me 17 vjet burgim për veprën penale të "Vrasjes me dashje", parashikuar nga neni 76 dhe 278/2 të Kodit Penal", - thuhet në njoftimin e policisë. Në datë 20.10.1995, shtetasi Astrit

Picari pas një konflikti në një lokal në zonën e Vorës ka ndjekur dhe më pas ka vrrarë me armë zjarri, për motive të dobëta shtetasin K.M. Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tiranës me Autoritetet Skoceze, u bë i mundur arrestimi i tij në Edinburg/Skoci dhe ekstradimi i tij drejt vendit tonë.



Foto ilustruese

GRUPI I HABILAJVE INTERVISTA/PJESA E DYTE

Denoncimi "bombë" i oficerit të Antidrogës, Antonio Nazeraj

"Si ua shpërndanin shefat e policisë trafikantëve farën e kanabisit, merrin 30%"

"Bordi" bënte takime çdo muaj. Telefonata nga Tirana 'më arrestoi'"

Basir Çollaku

(vijon nga nr. i djeshëm)

Ish-agjenti i Antidrogës në Drejtorinë e Policisë Fier, Antonio Nazeraj në pjesën e dytë të intervistës dhënë për "Gazeta Shqiptare" tregon vijimin e situatës së vështirë që hasi pas denoncimit të Habilajve duke bërë një denoncim "bombë". Ai rrëfen se si ua shpërndanin shefat e policisë trafikantëve farën e kanabisit duke përfituar 30% si dhe jetën e tij të re...

Por, ju vazhduat punën nuk u larguat, por u arrestuat?

Unë nuk e kam lënë detyrën, madje eprorit tim i kisha thënë se do të qëndroj në detyrë dhe nuk e lë asnjë sekondë punën, që kam dhe më tha bëje për familjen, nëse nuk e bën për vete, pasi ai kishte shumë informacion për këto grupe kriminale dhe trysinë që ushtrohej ndaj tij nga lart.

Dhe me 17 korrik jeni arrestuar?

Këtë detyrë nuk e kam lënë deri me datë 17 korrik. Më herët, diku në fund të muajit qershor, kam pasur një takim me një prokuror.

Përse ju kishte thirrur?

Më ka marrë oficeri i SHKB në telefon dhe më ka thënë se ka lënë një takim prokuroror me ty. Vajta dhe poshtë prokurorisë po më pristë shefi i SHKB, Melsi, i cili erdhi pas meje kur u ngjita në zyrën e prokurorit. Prokurori i kërkoi të dilte nga zyra se do merrte deklarinimin tim, ndërsa Melsi nuk pranoi të dilte dhe thoshte se nuk dal, do të dëgjohet se çfarë deklarimi do të marrësh. Pati një debat mes prokurorit dhe shefit të SHKB, sepse kur më ka pyetur prokurori dhe më ka thënë se, përse e kisha lënë detyrën, pasi sipas tij unë nuk shërbeja më në Policinë e Shtetit. I them që jam ende në detyrë dhe po vij nga puna në Lushnjë drejt në prokurori. Prokurori debatoi me Melsin kur i tha se më ke sjellë informacione të rreme

Sipas SHKB?

Sipas SHKB, tha prokurori, unë kisha lënë detyrën në polici dhe i isha shmangur një hetimi. Detaji tjetër ishte kur prokurori ka pyetur mua dhe shefin e SHKB, kur isha në punë kur flitej për një kontroll automjeti, i kam thënë se kam qenë oficer antidrogë dhe jo qarkullimi që kisha bërë kontrollin e një automjeti për patentë.

Ju pranuat që ai të qëndronte aty?

Ai nuk dëgjonte të dilte nga zyra, me sa kuptova e kishte porosi nga shefat e tij. Më tha



Antonio Nazeraj

prokurori nëse mund të qëndrojë. I përgjigjem se këtë nuk e di unë, por ju. Atëherë më tha se do të të thërras një ditë tjetër për të të marrë një deklarinim. Pastaj jam larguar për në punë.

Dhe kur ju ndaluan?

Më kanë ndaluar me datë 16 korrik 2014, mes datës 16 dhe 17 në mesnatë. Kur lashë detyrën në orën 16 më morën në telefon dhe më thanë se duhet të vish në Komisarjatin e Fierit. Dhe aty rreth orës 22 të darkës më kanë arrestuar

thënë se këtij personi patentën ia ka bllokuar zyra e trafiqeve, sepse ishte kontingjent për trafik femrash dhe fëmijësh dhe firmoste një herë në javë në Drejtorinë e Policisë Fier, ishte me detyrimin paraqitjeje. Kam pasur informacionin se ky njeri ishte informato i SHKB dhe të gjithë këto veprime e akuzat janë gatur nga oficerët e SHKB. Kemi pasur edhe raste të tjera kur na janë ankuar persona, të cilët janë kërcënuar nga oficerët e SHKB, që të sajorin akuzat ndaj nesh.

"Isha i pafuqishëm, kam pasur kundra qeverinë, një shtet kundër, më ka thënë dhe avokati që puna jote që ke bërë ka ndikuar në burgosjen tënde, nuk e dimë ku ke goditur ndonjë njeri të pushtetit, nuk shoh asnjë provë dhe nuk e di se për çfarë je burgosur. Nuk ka asnjë fakt dhe asnjë provë".

Përse ju kanë arrestuar, cila ishte akuzat ndaj jush?

Më kanë akuzuar me pretendimin, akuzën e korrupsionit pasiv, sepse pretendonin se unë si oficer, bashkë me dy agjentët e mi, kishim kontrolluar një automjet në fshatin Qarr dhe, sipas akuzës, ne i kemi bërë kontroll këtij personi, duke i bërë favor dhe e lënë të lirë, ndonëse ai nuk dispononte patentë dhe ne, sipas akuzës, kemi përfituar 80 mijë lekë të vjetra tre se bashku.

Dhe ju e latë?

Ne për këtë person kemi marrë sallën operative dhe ata na kanë

Shkuat në burg?

Kur kam dalë në gjyq dhe gjykata më ka njohur me masën e arrestit me burg, jam habitur, ndonëse e mora vesh mirë se si u sajua, atëherë i thashë avokatit të pak të më dërgojnë në një burg, ku të kem siguri për jetën.

Ku të dërguan?

Më dërguan në burgun e Rrogzhinës. Kur e kam pyetur avokatin dhe i thashë të paktën të më dërgojnë në një burg ku të ketë siguri, të mos më dërgojnë në një burg ku ishin të arrestuarit e mi, sepse kisha tetë vjet në zyrën e antidrogës, dhe të shumtën e të

arrestuarve unë i kisha në Rrogzhinë dhe në Peqin. Avokati më ka thënë se ka pasur një telefonatë të fuqishme ndaj prokurorit të rrethit për ty dhe nuk e marrin mundimin as prokuroria as gjykata se ka pasur kërcënime nga kërret e lartë të Ministrisë së Brendshme për ty.

Çfarë i kishin kërkuar prokurorit dhe kush i kishte telefonuar?

Me sa informacion mora nga avokati, më tha se është një telefonatë shumë e fuqishme, telefonatë e tillë ose nga drejtori i Përgjithshëm ose nga ministri të bëra prokurorit të rrethit për burgosjen time.

Ishit i pasigurt edhe në burg?

Kur kam shkuar në Rrogzhinë, ka ardhur drejtori i burgut, pas një ore ku kam qëndruar në hyrjen e ambientit të burgut dhe më ka thënë se ke punuar oficer me Antidrogën, po, i përgjigjem. Më thotë se është e pamundur që ne të mbrojmë dhe mbajmë këtu, sepse jemi jashtë mundësive tona, sepse të burgosurit ka dy ditë që e kanë marrë vesh ardhjen tënde dhe janë duke bërë festë për ty... një festë e madhe dhe po të presin me dashuri... Ne e kemi të pamundur të të sigurojmë, më tha, ndaj do të flas me drejtorin e Përgjithshëm që të të transferojë në një burg tjetër, pasi, ne si polici e burgut, nuk e garantojmë sigurinë tënde fizike

Pastaj?

Ka folur me drejtorin e Përgjithshëm dhe pastaj më kanë dërguar në burgun e sigurisë së lartë në Peqin

Po aty ishit më i sigurtë?

Edhe aty ka pasur shumë nga personat që ne kishim arrestuar, që vuanin dënimin në atë burg. Më kanë çuar në një qeli, ku ishin dhe dy të tjerë, njëri prej të cilëve ishte i dënua për dy vrasje dhe aty më kanë kërcënuar të dënua për trafik dhe të bandave për të cilat ne po flasim. Nuk më linin të dilja në ajrim dhe kam qëndruar gjashtë muaj në qeli, sepse kisha frikë dhe policët nuk më siguronin dot, nuk jam lejuar prej tyre që të dal, nuk më jepnin siguri. Në dy raste kishte dhe policë që mbanin respekt ndaj policit dhe si ish-koleg dhe në dy raste persona me burgim të përjetshëm më janë futur në qeli, por ndërhyrja e policisë bëri që të largoheshin. Këto persona e dinin se kush isha unë dhe shanin oficerët e Antidrogës dhe në këto momente kanë ardhur policët e burgut duke shmangur incidentin.

Pas katër muajsh sërish Melsi në qeli?

Po, ka ardhur për të më komunikuar akuzën. Më erdhi me një copë letër dhe më ka thënë se du-



Moisi Habilaj

het të firmosësh këtë procesverbal pasi nuk e kam me vete dosjen hetimore që të njihesh me aktet, procesverbalet dhe aktet e dosjes hetimore.

Nëse do ta firmosje ok, nëse jo, atëherë do të presësh dy vjet apo më shumë, më tha duhet të firmosësh ose të presësh

S'ju kish marrë në pyetje prokuroria?

Jo s' më ka ardhur ndonjë prokuror. Vetëm ditën e dytë, kur jam ndaluar, që më ka marrë deklarinimin e parë, dhe më tej asgjë. Pas katër muajsh shefi i SHKB-së, ku kam firmosur një letër bakalli dhe kam firmosur duke pranuar se janë mbyllur hetimet dhe në të thuhet se s'ka fakte të tjera dhe unë s'jam njohur me asgjë nga dosja, asnjë akt apo procesverbal dhe vetëm me një takim.

Pastaj u liruat?

Pastaj më liruam me shërbim prove. E dija se ishte lojë. Isha i pafuqishëm, kam pasur kundra qeverinë, një shtet kundër, më ka thënë dhe avokati që puna jote që ke bërë ka ndikuar në burgosjen tënde, nuk e dimë ku ke goditur ndonjë njeri të pushtetit, nuk shoh asnjë provë dhe nuk e di se për çfarë je burgosur. Nuk ka asnjë fakt dhe asnjë provë

Pastaj u larguat?

Po vendosa të largohem jashtë shtetit me familjen time, sepse e kisha të pamundur qëndrimin, pasi kisha kanosje të vazhdueshëm për vete dhe familjen.

Për denoncim kua i vonuar?

Duke parë dhe situatën në Shqipëri kam dashur që familjarët e mi të ishin më të sigurtë, edhe ata janë të rrezikuar.

Ja keni thënë prokurorisë këto rrezele?

Jo, asnjë prokurori dhe asnjë polici, sepse nga informacionet e mia, këta kanë qenë kokë e këmbë të lidhur me krimin

Fieri një zonë e nxehtë?

Po. Fieri një vatrë e nxehtë për trafikun e drogës si kanabis ashtu dhe heroinën dhe kokainën, heroina që vinte nga Afganistani.

Po nuk nisi në 2013?

Jo, por me ndërrimin e pushtetit këto trafikantë u bënë njësh me eprorët e policisë dhe Ministrisë së Brendshme.

Më keni thënë më herët, se më herët nuk jeni tradhtuar →



← nga eprorët?

Jo asnjëherë, nuk kemi pasur këto probleme aspak, ndonëse vështrësi ka pasur jo pak, se antidroga nuk ka punë të lehtë. Ndërrimi i pushteteve, këta trafikantë të drogës bashkëpunonin dhe bënin takime me krerët të Policisë së Shtetit, ku ndanin euro, ndanin parcelat, ndanin...

Te lutem, Nazeraj, ju thonë që trafikantët e drogës dhe krerët e bandave bënin takime periodike mes tyre?

Po. Bënin takime këto grupe trafikantësh, këtë banda që operonin në trafikun e drogës, bënin takime periodike me eprorët të Policisë së Shtetit, kundrejt pagesave dhe shpërblimeve...

Kemi një bord të mafias që mbledhet një herë në muaj, në javë, apo...?

Ka qenë një bord i mafias, pothuajë e quaj unë me eprorët të Policisë së Shtetit dhe trafikantëve të drogës.

Sa takime periodike bënin në javë, muaj apo...?

Në ditë një timë këto mbledheshin një herë në muaj.

Dhe ku mbledheshin?
Kishin vende të veçanta që mbledheshin, nëpër hotele, restorante, me aq informacion që kisha unë.

Çfarë bënin, përse takoheshin?

Këta ndanin detyra dhe linin detyra, krimi merrte detyrat, që u linin këta krerët e lartë të policisë, ndanin edhe pjesën e tepsisë më saktë, se sa ishte gjoba, sepse kjo ishte pothuajse një gjobë kundrejt trafikantëve të drogës, ishte edhe gjobë edhe ndarje detyrash mes tyre, ndarja e detyrave dhe hapja e rrugës për trafikun e drogës.

Me çfarë trafikohet?

Me skafe, me avionë të vegjël sportivë, pasi ne kemi pasur informacione për këtë që në gusht të vitit 2013, që nisën këto avionët sportivë, sipas informacioneve që kishim ne të transportonin drogë nga Divijaka drejt brigjeve të Italisë. Indicet e para për trafik me avionë ne i patëm në gusht të vitit 2013, pastaj filloi të shtohet më tepër, si në skafë, ashtu dhe në avionë e vegjël sportivë.

Kryesisht kanabis apo edhe lëndë të tjera narkotike të shtrenjta?

Dosja "Habilaj", Antonio Nazeraj: Në burg kisha frikë për eliminim fizik nga ata

"Me emra nuk mund t'i themi të gjithë, tetë vite kemi pasur info goxha se si korruptoheshin"

Ish-agjenti i Antidrogës: Kërkova strehim për familjen e veten, ndjehesha i frikësuar

Kryesisht kanabis, por sigurisht edhe lëndë të tjera narkotike, droga të shtrenjta.

Do i rikthehem këtij takimi të bordit të mafias, si funksiononte skema, sa merrnin pagesë policia, për parcela për rrënjë, si veprime, sipas informacioneve që ju kishit?

Ka pasur shpërblime siç e përmenda për hapjen e rrugëve të trafikut të drogës me skafë dhe avionë të vegjël, por që fillon edhe kultivimi i kanabisit, në masë të gjerë dhe sipas informacioneve që kam pasur unë. Farën e binin direkt eprorët e Policisë së Shtetit dhe u ndanin trafikantëve. Ishte fara direkt, nga eprorët e policisë së shtetit dhe ju ndahej trafikantëve të zonës.

Po drejtuesit e policisë lokale?

Tani, aty nuk bëhej fjalë për policë se ata nuk kishin mundësi të ngrinin krye. Po e përsëris kjo bëhej nga eprorët të lartë të Policisë së Shtetit, zinxhiri i policisë, nga qendra dhe kjo farë pastaj ndahej për trafikantët dhe kultivuesit e lëndëve narkotike.

Në këto takime periodike bëhej edhe shpërndarja e bazë mallit..?

Bëhej madje sipas informacioneve, që kisha, u shisnin edhe farën, shefa komisarriatesh, apo drejtorë qarqesh u shisnin edhe farën këtyre trafikantëve, u merrnin edhe përqindjet, dikëta të 30 përqind dhe pastaj kishin edhe shitjen dhe transportin e kanabisit që u merrnin trafikantëve dhe u hapnin rrugë për trafikimin në vende si Italia dhe Greqia. Kjo vazhonte nga fara, kultivimi, dhe trafikimi, ka qenë krejtësisht një organizatë, e mirëstrukturuar që fillonte nga krerët e lartë të Policisë së Shtetit, të trafikantët.

Me bekim nga lart dhe e shtirë në gjithë qarkun?
Kjo me sa informacion kam unë, kjo skemë u hap në gjithë territorin e Shqipërisë.

Ata ishin të sigurt?

Patjetër, se atyre s'mund t'u japë një inspektor zone t'u dalë zot gjithë atyre parcelave, nuk ishin 5 dhjetë apo 20 rrënjë, s'mund të lërë parcela pa fund.

Përveç këtij grupi të Habilajve ka pasur dhe të tjera?

Ka pasur në qarkun tonë grup të tjera të strukturuar kriminale, që ushtronin aktivitetin në qarkun tonë dhe më tej kryesisht dhe të heroinës dhe të kokainës.

Grupet e tjera në Fier, Vlorë?

Kishte grupe kriminale që kanë vazhduar gjatë gjithë kohës, ka pasur vullnet e dëshirë për t'i luftuar gjatë gjithë kohës.

Sa grupe të strukturuar kriminale kishte sipas infove tuaja në këtë zonë?

Në qarkun e Fierit janë të pakten katër grupe kriminale që kanë operuar në fushën e narkotikëve, heroinës dhe kokainës, që bënin trafikimin në Greqi dhe Itali si dhe kanabis. Heroina vinte nga Stambolli nga Turqia, por me prejardhje nga Afganistani që më pas trafiko-



Florian Habi

hej në Greqi, si dhe kokaina.

Kishin mbrojtje pushtetit?

Në ato vite që kam punuar të them të drejtën nuk e kam ndjerë asnjëherë veten të kërcënuar nga shteti para 2013, por më pas krerët e policisë dhe Ministrisë së Brendshme u bënë njësh me bordin e mafias. Këta kishin shumë mbështetje politike. Këta vendosnin dhe emëronin dhe oficerët, shefa policie, drejtorë policie, në rreth të ndryshme, apo oficerë në drejtori policie, që i vendosnin, ata bandat vendosnin.

Ky bord bënte dhe emërimet?

Bënte dhe emërimë në policinë e shtetit, që kurrë s'kishte ndodhur

Kanë mbështetur politikanë këto grupe?

Këto grupe kriminale kanë pasur goxha mbështetje dhe u bënë shumë të fuqishëm në muajt në vijim.

Heroina dhe kokaina një problem i madh, cilat linja funksiononin?

Ne kemi pasur në hetim gjatë atyre viteve të drogës që vinte nga Turqia dhe kokaina nga Brazili, ku ka pasur eksponentë të njohur në fushën e heroinës, kishim një grup kriminal që sillte kokainën nga Amerika Latine, nga Brazili, nëpërmjet kamionëve të vegjël, që përdorshin kryesisht për pulat e ngrira.

Kishte një biznes që e mbulonin këtë trafik?

Po ka pasur një biznes, ka pasur disa biznese që mbulonin trafikun e kokainës nga Brazili në Shqipëri, disa subjekte, ka qenë një bord, një grupim, që ndanin pjesët me përqindje, dhe bënin logaritë e shitjes së kokainës.

Vinte nga Brazili për ku?

Destinacioni i kokainës në shumë raste, marr shembull një grup, zhdogononte në Mal të Zi, pastaj futej në Shqipëri, në Veri të Shqipërisë dhe më pas vinte në Fier dhe shpërndahej në vende të ndryshme.

Fieri si magazinë?

Le të themi se ka qenë një laborator i kokainës. Nga infot që ne kemi ndjekur kjo bandë e trafikut të kokainës e mbulonte me shitjen e pulave të ardhura nga Brazili. Kemi pasur në ndjekje një tjetër biznes, biznes i ujit të pijshëm në Jug të vendit. Dhe ky e mbulonte këtë biznes dhe merrej me trafikun e heroinës nga Afganistani në Shqipëri, më pas transportonte në Greqi.

Përse si arrestonit këto?

Kanë qenë gjithnjë në hetim, por vitin e fundit ishte e pamundur të vepronin, kishim një operacion konkret me arrestime.

Ka një episod për t'ju korruptuar?

Kemi sekuestruar dhe ndaluar mjetin dhe ofruar 50 mijë euro t'i linim të lirë dhe dhjetë mijë euro që mos t'i linim të lirë.

Dhe ne e dërguam në burg. Kemi bërë sekuestrimin e heroinës, janë bërë veprime hetimore, ishte një grup shumë i strukturuar kriminal që doli më pas nga transkriptimet, por me terrorin e muajve të fundit nga SHKB, dhe eprorët e Policisë së Shtetit ishte e pamundur të hetojë këto grupe kriminale, pasi kishte dhe dhjetë persona të tjerë grupesh kriminale në trafik me destinacion Athinën, kishte persona të tjerë nga Fieri, Berati, Mallakstra në këtë grup kriminal. Por pjesa e krerëve të policisë, gjykatës dhe prokurorisë kanë paguar shuma të mëdha parash dhe ky hetim pastaj ngeli, isha në ditët e fundit, kur jam transferuar në Lushnjë.

Ka ardhur një zyrtar nga Amerika Latine, një trafikant?

Gjatë hetimit që kemi pasur për një trafik drogë kokainë, që vinte nga Brazili në këtë episod ishte përfshirë dhe një shtetas nga Amerika Latine, nga Kili apo Brazili, më duket një ish-ministër, i cili ishte përfshirë në trafik drogë dhe erdhi në Fier pasi ka pasur një ftesë nga ish-kryetari bashkisë në atë kohë, për planin

e rregullimit të qytetit të Fierit, sipas informacionit që morëm në bashki, por, sipas hetimit tonë, ishte i përfshirë në trafikun e kokainës që vinte nga Brazili në Shqipëri dhe në Fier. Ky person ka pas bashkëpunim me disa persona që ne kemi pasur në hetim për trafikun e kokainës si dhe një grup kriminal të mirorganizuar në qytetin e Vlorës.

Një tjetër zyrtar që më shumë bënte mbledhje partie se policie?

Po në atë kohë më kujtohet se ish-ndrejtori i policisë është munduar të fshehtë një dosje kontingjenti të një ish-funksionari të lartë të partisë në pushtet, ishte nipi funksionari të lartë, ky ndrejtor ishte një njeri shërbimesh në kohën e diktaturës.

Grupe të mëdha biznesi në kokainë heroinë, kishte vrasje, gjoba?

Pengmarrje e vrasje ka pasur, por këta, kohë pas kohe, kanë korruptuar gjykatën dhe policinë, por dhe krerët e lartë të Policisë së Shtetit

Gjykatës e prokuror të korruptuar?

Gjykata dhe prokuroria pjesë e sistemit të korruptuar.

Mos e bëjmë teorike, ju ka qëlluar konkretisht?

Po, jemi hasur, por edhe me emra nuk mund t'i themi të gjithë, pasi tetë vite kemi pasur info goxha se si korruptoheshin, duke parë dhe vendimet e gjykatës që me gjithë provat tona ata dilnin pa lagur.

Nëse drejtësia funksionon, ju do ia përcillnin këtë rrëfim asaj?

Po, patjetër. Nëse do të funksiononte do të isha i gatshme t'ia përcillja këto informacione, dhe informacione të tjera.

Aktualisht ku gjendeni?

Unë gjendem në një shtet të Bashkimit Evropian ku kam kërkuar strehim dhe mbrojtje për familjen time.

Kjo që ju thonë është e provueshme?

Po, është e provueshme, sepse këto gjëra kanë ndodhur dhe me këto persona unë përballem në çdo kohë.

Pas zgjedhjeve si reagonin këto grupe kriminale?

Me sa me kujtohet ka pas takime të ndryshme, nga ish-kreu i Partisë Socialiste sot kryeministër, me disa trafikantë, në një hotel në Tiranë, nga gjitha rrethet e vendit, por mes tyre kanë qenë dhe persona me precedentë penale nga qarku i Fierit

Ju nga e morët vesh?

Po ne ngaqë ndiqnin trafikantët nga qarku unë kishim goxha të dhëna, nga trafikantët apo njerëzit afër të tyre, kish mbledhur për t'i falënderuar pas zgjedhjeve parlamentare dhe për t'u lënë detyra të mëtejshme. Në një moment hyn një insekt që zhurmoi aty dhe në atë moment kryeministri ka thënë pushoni se po na ndjeka, na përgjon amerikani... e kanë qeshur bashkërisht... personi ka qenë njëri nga të afërmit e trafikantëve.

Ndryshimi i ministrive, do të paguhen nga taksat 81 mijë e 660 punonjës

Administrata, vendet e punës që rrezikohen në 2018

Shkurtohen vetëm 50 vende pune

Ornela Manjani

Në administratën publike vitin e ardhshëm do të punojnë 81 mijë e 660 punonjës. Shifra është bërë e ditur në projektbuxhetin e vitit 2018, ku janë parashikuar përveç numrit të përgjithshëm të punonjësve, edhe numri i të punësuarve për çdo ministri, drejtori dhe institucion buxhetor. Edhe pas ristrukturimit të përbërjes së qeverisë, ulja e numrit të të punësuarve është e vogël, 50 vende pune. Në vitin 2017, numri i punonjësve buxhetorë është 81 mijë e 713 punonjës. Në Kryeministri do të punojnë 150 persona, në Kuvend 405 dhe në Presidencë 86. Numrin më të lartë të punonjësve me 31004 e ka Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, më pas vjen Ministria e Brendshme me 14 106 punonjës. "Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 81 660 veta. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore, në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve, në rastin e ris-



Ministri i Ekonomisë dhe Financës, Arben Ahmetaj

ADMINISTRATA

Pas ristrukturimit të përbërjes së qeverisë, ulja e numrit të të punësuarve është e vogël, 50 vende pune. Në 2017, numri i punonjësve buxhetorë është 81 mijë e 713 punonjës. Në 2018 në Kryeministri do punojnë 150 persona, në Kuvend 405 dhe në Presidencë 86.

strukturimit të institucioneve ekzistuese apo krijimit të institucioneve të reja", thuhet në projektbuxhet. Numri rezervë përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve të reja. Këshilli i Ministrave përcakton numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 500 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret

me miratimin e ministrit të Financave dhe sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të tij.

STRUKTURA

Për vitin 2018 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të një-sive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përllorarit sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë. Ky përcak-

tim përfshin edhe ato struktura, në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shqyrohet me efektet financiare shtesë në koston e përllorarit sipas gradave të miratuara. Numri i punonjësve të institucioneve ekzistuese të sistemit të drejtësisë dhe numri rezervë për këtë sistem është 230. Detajimi i numrit të punonjësve të institucioneve ekzistuese të sistemit, deri në momentin e riorganizimit, detajohet nga vetë institucionet. Rishpërndarja e numrit të punonjësve të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe e numrit rezervë të tyre bëhet nga Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak nga Kuvendi", shkruhet në relacionin e projektbuxhetit 2018.

AUDITIMET I KLSH-së

Buxhetit të shtetit, dëm 720,5 milionë euro

A**u**zimet me buxhetin e shtetit arrijnë në 720,5 milionë euro. Të dhënat janë bërë publike në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku mësohet se nga auditimet e realizuara gjatë periudhës janar-shtator 2017 janë konstatuar parregullsi dhe shkelje financiare që i përkasin periudhës objekt auditimi 2014-2016. Parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 9,226 milionë lekë (69 milionë euro), nga e cila ka rekomanduar për shpërbllim dëmi shumë 5,601,6 milionë lekë. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 86,961 milionë lekë, afërsisht 651,3 milionë euro nga e cila: 81,244 milionë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 608,5 milionë euro dhe 5,717 milionë lekë afërsisht 42,8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve. Në raport thuhet se janë konstatuar shkelje në shumën 96,188 milionë lekë ose afërsisht 720,5 milionë euro. Për vitin 2016, rritja e detyrimeve ndaj tatimeve dhe doganave (borxhi tatimor dhe doganor) si dhe skemës së sigurimeve shoqërore është në vlerën 51,175 milionë lekë, ose 41% më e lartë se viti 2015. Për periudhën janar-shtator 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga 124 auditime të planifikuara ka ushtruar dhe ka vijuar me përgatitjen e materialeve për 136 auditime. Sipas llojit, auditimet e zhvilluara për këtë periudhë janë 90 dhe klasifikohen si më poshtë: 69 janë auditime të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë; 6 janë auditime përputhshmërie; 7 janë auditime financiare; 6 janë auditime performancë; 2 janë auditime IT.

Tatimet: Bizneset që s'do përdorin kasë fiskale

Tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedisë apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, janë të detyruar të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kuponë tatimorë për çdo transakcion. Tatimpaguesi që kryen qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, ose institucioneve financiare të parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, është i detyruar të instalojë dhe përdorë pajisje fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë, si dhe për lëshimin në mënyrë të detyrueshme të kuponit tatimor. Nuk janë të detyruar të përdorin pajisje fiskale tatimpaguesit, që paguajnë tatime mbi të ardhurat nga kryerja e veprimtarive për shumta të vogla të të ardhurave neto, ambulantët, me përjashtim të shoferëve të taksi, personat që nuk janë tregtarë dhe e realizojnë qarkullimin e produkteve bujqësore dhe të papërpunuara mbi tezza, në tregjet e organizuara, si dhe jashtë tregatave. Individët që lëshojnë me qira mjedisë biznesi; veprimtaritë, të cilat ushtrohen në zona të larta malore, me popullim më pak se 300 individë dhe që janë të ndryshme nga vendet turistike.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë"**.


Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,388,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfytuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 16 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,604,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfytuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 17 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Prokuroria italiane mbyll hetimet për 4 shqiptarët

Ndihmuan të arratiseshin nga burgu roman 3 të dënuar për krime të rënda

ITALI-Prokuroria e Romës në Itali ka mbyllur hetimet për 4 shqiptarë që natën e 27 tetorit të vitit të kaluar kanë ndihmuar 3 të dënuar, edhe ata shqiptarë të arratisen nga burgu roman i Rebibbias. Bëhet me dije se akuzat e ngritura ndaj tyre nga prokurorët Michele Prestipino dhe Nadia Plastina është ajo ndihmës për arratitje. Nga dinamika e arratisjes, është qartësuar se tre qytetarët shqiptarë të arratisur Tesi Basho (i

ARRESTIMI

Hetimet e policisë së Romës dhe Milanos janë bazuar fillimisht dhe esencialisht në një kompleks analizash të tabulateve telefonike të familjarëve të secilit prej të dënuarve. Falë zbulimeve është arritur të zbulohen 4 bashkëpunëtorët, që u arrestuan më 13 korrik.

dënuar përjetë); Ilir Pere (i mbaronte dënimi pas 25 vjetësh për tentativë vrasje) dhe Mikel Hasanbelli (fundit i dënimit në 2020 për grabitje dhe shfrytëzim prostitucioni), që u arritën të lokalizoheshin dhe të

kapeshin më 11 shkurt në provincën e Komos, kishin planifikuar me kujdes arratitjen. Katër bashkëpunëtorët në fakt, i kanë pritur jashtë burgut dhe i kanë marrë me makinë jashtë mureve të burgut, duke iu mundësuar



të largohen me shpejtësi. Hetimet e policisë së Romës dhe Milanos janë bazuar fillimisht dhe esencialisht në një kompleks analizash të tabulateve telefonike të familjarëve të secilit prej të dënuarve. Falë zbulimeve është arritur të zbulohen 4 bashkëpunëtorët, që u arrestuan më 13 korrik. Ditët e fundit nuk kanë qenë të pakta rastet që na kanë njohur

me shqiptarë të implikuar në banda droge, trafikim dhe vjedhje. Para pak ditësh u arrestuan nga Guardia di Finanza, 36 persona për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Policia italiane tha se kishte sekuestruar rreth 2 tonë drogë në Firence dhe shumica e personave të arrestuar janë me origjinë shqiptare.



Kërcënim me bombë në mitingun e LDSM-së ku do fliste Zoran Zaev

MAQEDONI- Një ngjarje e rëndë është regjistruar ditën e djeshme në tubimin e partisë LDSM të Zoran Zaevit. Mediat maqedonase pohojnë se një 44-vjeçar me inicialet T.J., ka kërcënuar që do të hidhte një bombë në mitingun e kësaj partie, në Obelshëvë, një zonë e Maqedonisë lindore, ku ka ende bazat e forta VRMO-ja e Gruevskit. Ndërkohë, burimet policore bënë me dije se 44-vjeçari donte me çdo kusht që të hidhte një bombë, që të ndalte fjalimin e kryetarit të partisë. Sakaq, pasi është marrë në pyetje, 44-vjeçari është larguar nga komisarati. Ky është incidenti më i rëndë, në fakt, në zgjedhjet lokale të Maqedonisë, të parat të administruara nga qeveria e Zoran Zaevit.

Policia zbulon marrëdhëniet shoqërore me marokenët pro-islamike

Dëbohen nga Italia shqiptari dhe maqedonasi, kishin lidhje me ISIS

Zbardhet biseda "pro" terrorizmit

Egla Xhemali

ITALI

Dy persona, një shqiptar dhe një shqiptarësi maqedonas janë dëbuar nga shteti italian për arsye të sigurisë kombëtare. Mediat fqinje raportojnë lajmin, bazuar tek informacionet e Ministrisë së Brendshme italiane, ndërsa shkruajnë se një maqedonas 36-vjeçar dhe një 27-vjeçar shqiptar, banorë në provincën e Barit, ishin monitoruar prej kohësh nga policia, pasi rezultoi që ata kishin marrëdhënie të ngushta shoqërore me disa marokenë pro-islamike. Mes të tjerash 'Ansa' shkruan se policia italiane kishte vërtetuar se dy personat në fjalë kishin bashkëpunim edhe me ekstremistët dhe predikues radikal të arrestuar në Kosovë për vepra terroriste. Gjatë kontrolleve të ushtruara nga policët dy emigrantët kishin në kompjuter materiale komprometuese me përmbajtje anti-perëndimore. Fill pas këtyre zbulimeve, shqiptari dhe maqedonasi, identiteti i të cilëve nuk dihet, u dëbuan me avion për në Shtetet e tyre. Për këtë vit janë lëshuar 89 urdhra dëbimi, ndërsa nga janari 2015 e deri tani, në total 221. Një rast tjetër i arrestimit të një pedagogu shqiptar nga policia e Malajzisë, bëri bujë fillim muajin e tetorit. Mbi të rëndonte akuzat e terrorizmit. Pedagogu ra në prangat e policisë gjatë një aksioni të gjerë, bashkë me tre filipinez dhe katër malajzianë, të cilët dyshoheshin se janë të lidhur me grupin terrorist Abu Sayyaf. Arrestimet u kryen në Sabah, Selangor dhe Perak, nga 27 shtatori deri më 6 tetor. Mediat e




„'Ansa' shkruan se policia italiane kishte vërtetuar se dy personat në fjalë kishin bashkëpunim edhe me ekstremistët dhe predikues radikal të arrestuar në Kosovë për vepra terroriste. Gjatë kontrolleve të ushtruara, emigrantët kishin në kompjuter materiale komprometuese me përmbajtje anti-Perëndimore.

huaja raportuan se shqiptari i arrestuar ishte pedagog në një universitet publik, ndërsa ka pasur kontakt me Shtetin Islamik (ISIS). Abu Sayyaf është një grup militant xhihadist, që operon kryesisht në Filipine dhe Malajzi.




Meral, "zonja e hekurt" në Turqi, krijon partinë për të sfiduar Erdoganin

